



**KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT
ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE**

**RAPORT MBI SITUATËN E RESPEKTIMIT TË TË
DREJTAVE TË NJERIUT NË SHQIPËRI
PËR VITIN 2014**

Tiranë, Dhjetor 2014



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

Ky raport është përgatitur në kuadër të projektit “Përmirësimi i situatës të të drejtave të njeriut në Shqipëri nëpërmjet forcimit të shtetit të së drejtës – Klinika ligjore VIII”, zbatuar nga Komiteti Shqiptar i Helsinkit dhe mbështetur financiarisht nga Civil Rights Defenders.



Përmbajtja e kërrij raporti është përgjegjësi e plotë e Komitetit Shqiptar të Helsinkit dhe nuk reflekton qëndrimin e Civil Rights Defenders.

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara për subjektin autor. Asnjë pjesë e këtij botimi nuk mund të riprodhohet pa lejen dhe citimin e tij.

Autor:

©Komiteti Shqiptar i Helsinkit

Rr. Brigada e 8-te, Pallati “Tekno Projekt”

Shk 2 Ap 10, Tirana-Albania

Kutia Postare nr.1752

Tel: 04 2233671

Cel: 0694075732

E-mail: office@ahc.org.al;

Ëeb site: www.ahc.org.al



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

SHKURTIME TE FJALËVE

Komiteti Shqiptar i Helsinkit	KShH
Civil Rights Defenders	CRD
Instituti për Zhvillimin e Kërkimeve dhe Alternativave	IDRA
Autoriteti Kombëtar i Ushqimit	AKU
Këshilli i Ministrave	KM
Inspektoriati Ndërtimor Urbanistik Kombëtar	INUK
Drejtoria e Prërgjithshme e Burgjeve	DPB
Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi	KMD
Kontrolli i Lartë i Shtetit	KLSH
Agjencia e Legalizimit Urbanizimit dhe Integritit të Zonave/Ndërtimeve Informale	ALUIZNI
Agjencia e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave	AKKP
Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut	GJEDNJ
Radio Televizioni Publik	RTSH
Instituti i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive	ILDKP
Këshilli i Lartë i Drejtësisë	KLD
Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut	KEDNJ
Institucioni Ekzekutimit të Vendimeve Penale	IEVP



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

HYRJE

Komiteti Shqiptar i Helsinkit ka përgatitur këtë raport për situatën e respektimit të të Drejtave të Njeriut në vend, për vitin 2014 dhe shpreson që ai, jo vetëm të mirëpritet nga publiku, por dhe të nxitë institucionet shtetërore që të reflektojnë pozitivisht me veprimtarinë e tyre dhe të rritin më shumë kujdesin për respektimin e lirive dhe të drejtave njerëzore. Gjithashtu shpresojmë që ky raport t'u shërbejë organizatave të shoqërisë civile në veprimtarinë e tyre.

Për përpilimin e këtij Raporti kemi shfrytëzuar: gjetjet që kanë rezultuar nga veprimtaria monitoruese e KShH, veçanërisht në burgje, paraburgime, komisariate, spitale e qendra shëndetësore; problematikën që ka dalë nga kërkesat e ankesat, që kanë adresuar shtetasit tek organizata jonë; informacionet e marra nga mediet vendase; dhe raportet e organizmave kombëtare dhe ndërkombëtare.

Situata e të Drejtave të Njeriut, gjatë vitit 2014, ka filluar të marrë një kthesë pozitive, në disa sektorë, por përgjithësisht shkeljet dhe cenimi i lirive dhe të drejtave kanë vazhduar të evidentohen dukshëm edhe këtë vit. Raport ynë nuk trajton gjithë gamën e lirive dhe të drejtave të sanksionuara në Kushtetutë dhe akte ndërkombëtare, të zbatueshme në Republikën e Shqipërisë. Ne jemi ndalur dhe trajtuar një pjesë të tyre, veçanërisht të drejtat dhe liritë që na kanë rezultuar më shumë të cënuara dhe për pasojë kanë qenë shpesh objekt reagimi nga ana e shtetasve, si dhe tematikë e veprimtarisë sonë. Në këtë raport trajtohen problematika që flasin për cënimin e të drejtave që lidhen me jetën, me shëndetin dhe pasurinë e shtetasve, me lirinë e shprehjes, me të drejtën për proces të rregullt ligjor, me të drejtën për informim, me përfshirjen e pjesëmarrjen e shtetasve në çështjet me interes publik, por trajtohen gjithashtu dhe probleme madhore, që shqetësojnë vendin tonë, si korrupsioni dhe mbrojtja e mjedisit, të cilat direkt ose indirekt afektojnë të drejtat e shtetasve.

Një vëmendje e veçantë i është kushtuar situatës së respektimit të të drejtave të personave me liri të kufizuar. Pa dashur të paragjykojmë sjelljet dhe përmbushjen e detyrës nga ana e punonjësve të këtyre institucioneve, duhet pranuar se personat e akuzuar, ose dyshuar për kryerjen e veprave të kundraligjshme, duke qenë të izoluar në burgje, paraburgime dhe pranë mjediseve të komisariateve të policisë, mbartin një rrezik potencial për cënimin e të drejtave të tyre, për shkak se janë nën stresin e izolimit dhe larg syve të opinionit shoqëror e familjar. Prandaj mbrojtja e të drejtave të kësaj kategorie personash merr rëndësi edhe për faktin se, gjatë izolimit, ata janë totalisht nën kujdesin e strukturave të shtetit, nga të cilat pritet të japin modelin më të mirë për respektimin e legjislacionit dhe lirive e të drejtave të njeriut.

Është e rëndësishme të sjellim në vëmendjen e publikut se, për problemet dhe shqetësimet që përmban ky raport, KShH ka bërë reagimet dhe ndërhyrjet e nevojshme pranë organeve përkatëse, ose i është drejtuar opinionit të gjerë shoqëror kur problemet kanë qenë të rënda, flagrante, ose të përsëritura. Nuk kanë munguar edhe rastet e denoncimit penal të shkeljeve të konstatuara. Për t'u njohur me reagimet dhe ndërhyrjet tona mund të konsultoni faqen tonë të internetit, apo faqen e facebook-ut, ku janë pasqyruar raportet, studimet, deklaratat për shtyp, dhe dokumente të tjera të prodhuara nga KShH. Gjithashtu ju mund të na kontaktoni në adresën e KShH, në rrugë elektronike ose postare, nëse keni nevojë për materiale, ose hollësi të mëtejshme lidhur me situatën e të drejtave të njeriut në vendin tonë.

Vjollca Meçaj
Drejtore Ekzekutive



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Viti 2014 ka qenë një vit i rëndësishëm për Shqipërinë. Vendit ju dha statusi i vendit kandidat, duke shenjuar kështu një hap të rëndësishëm në rrugën tonë drejt integritit evropian. Me këtë rast BE i parashtrroi vendit për plotësim 5 detyra të rëndësishme, të cilat mbarten nga periudhat e mëparshme të procesit të integritit. Këto detyra lidhen me luftimin e krimit në përgjithësi dhe atij të organizuar në veçanti; luftimin e fenomenit të korrupsionit; krijimin e një administrate publike të kualifikuar dhe të depolitizuar; përmirësimin e veprimtarisë dhe forcimin e pavarësisë së pushtetit gjyqësor, si dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut.

Megjithë situatën e nderë politike që kaloi vendi, për shkak të bojkotit të punimeve të Kuvendit nga ana e opozitës, janë ndërmarrë disa reforma të rëndësishme të cilat janë orientuar, kryesisht, në drejtim të organizimit të pushtetit vendor dhe luftës kundër korrupsionit, si dhe për të luftuar pandëshkueshmërinë ndaj veprimeve në kundërshtim me ligjin. Përpjekje të mira janë bërë dhe lidhur me zgjerimin e mundësive për informimin e publikut rreth veprimtarisë së strukturave të shtetit dhe për ndërtimin e urave të bashkëpunimit me shoqërinë civile. Reforma të rëndësishme kanë filluar e po zhvillohen edhe në fushën e arsimit, të shërbimeve sociale dhe të shëndetësisë, të cilat pritet të ndikojnë pozitivisht në respektimin e të drejtave të shtetsve në këto fusha.

Në drejtim të mbrojtjes së jetës dhe shëndetit të shtetasve shteti ka detyrë të tregojë interesim të lartë, duke organizuar një sistem të përshtatshëm për ofrimin e shërbimit shëndetësor, duke përmirësuar e mbikëqyrur qarkullimin e shtetasve në rrugë, duke përmirësuar kushtet e mjedisit dhe duke garantuar tregtimin e ushqimeve dhe mallrave që nuk e dëmtojnë jetën e shëndetin e shtetasve etj. Gjatë vitit 2014 janë miratuar ose ndryshuar disa dispozita ligjore që tentojnë të përmirësojnë ofrimin e shërbimit shëndetësor si, ligji "Për Urdhërin e Mjekëve, ligji "Për Urdhërin e Stomatologut", ligji "Për Shërbimin e Urgjencës. Gjithashtu u miratua lista e re e barnave, që do të merren me rimbursim, ku janë shtuar 56 barna të reja. Megjithatë sektori i shëndetësisë ka ende shumë problem, të cilat lidhen me korrupsionin, standardet e ulta të shërbimit që ofron, infrastrukturën dhe organizimin. Veçanërisht problematik mbetet shërbimi shëndetësor dytësor, spitalet për sëmundjet e rënda, ato për sëmundjet mendore dhe shërbimi gjinekologjik, ku rezulton se ndërprerjet e shtatzënësisë janë bërë mbi bazën e preferencës gjinore të fetusit. Mediet kanë njoftuar se rezulton që shumë spitale dhe klinika publike të vendit janë në gjendje të mjerueshme.

Jeta dhe shëndeti i shtetasve janë dëmtuar edhe për shkak të kriminalitetit, i cili gjatë vitit 2014 ka vazhduar të jetë në nivele të larta. Vrasje, kanosje, plagosje, dhuna në familje, shkelje e rregullave të qarkullimit rrugor janë disa nga veprat penale që kanë cenuar jetën e shëndetin e shtetasve. Statistikat tregojnë një rritje të viktimave gra nga krimet e vrasjes. Shqetësuese ka qenë, në disa raste, mungesa e sigurisë për jetën dhe shëndetin në mjediset shkollore.

Organet e policisë kanë përmirësuar shërbimin e kontrollit të qarkullimit rrugor, megjithatë, deri në fund të Tetorit 2014 ishin rregjistruar 1599 aksidente rrugore, që kanë shkaktuar 209 të vdekur, 297 plagosje të rënda dhe 1701 plagosje të lehta. Mungesa e respektimit të rregullave të qarkullimit, gjëndja teknike e rrugëve, mungesa e sinjalistikës së duhur janë ndër shkaqet kryesore për vdekjen ose dëmtimin e pasagjerëve dhe këmbësorëve.



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

Dhuna në familje rezulton, gjithashtu në nivele të larta. Në Tiranë janë lëshuar urdhëra mbrojtjeje rreth 30% më shumë se një vit më parë. 79% e dhunuesve janë meshkuj dhe 21% femra, ndërsa recidivizmi është një tjetër fenomen që lidhet me dhunën në familje. Aabuzimi i fëmijëve shkaktohet më tepër nga babai dhe adresohet tek fëmijët meshkuj në masën 52% të rasteve dhe ndaj vajzave 48%.

Fenomeni i gjakmarrjes ende mbetet problem dhe vazhdon të marrë jetë njerzish. Sipas medias, vetëm në Shkodër rezultojnë zyrtarisht 53 familje të ngujuara për këtë shkak, ndërkohë që Komiteti i Pajtimit Mbarëkombëtar pretendon që numri i të vrarëve për hasmëri të jetë ulur 25 % dhe i vetëvrasjeve për shkak të gjendjes së hasmërisë 50 %, por institucionet publike nuk kanë prezantuar statistika zyrtare rreth shtrirjes së këtij fenomeni, ndërkohë që shumë shtetas, që pretendojnë se janë në një situatë të tillë kanë kërkuar azil në vende të BE.

Kontrolli i cilësisë së ushqimeve që tregtohen është me rëndësi për shëndetin e shtetasve. AKU ka ushtruar kontrole. Mjaft tregtarë ambulante u larguan nga trotuarët, ose mallrat u janë sekuestruar sepse nuk plotësonin standardet.

Dëmtime të shëndetit kanë ndodhur shpesh në miniera. Megjithëse për të gjitha rastet ka filluar ndjekje penale është e rëndësishme që dikasteri përkatës të ushtrojë kontroll më shpesh, e më mirë për kushtet e punës dhe të sigurimit teknik në miniera.

E drejta e pronës është parë e vlerësuar jo vetëm si një e drejtë subjektive, por dhe si një bazë për zhvillimin ekonomik të vendit. Në këtë drejtim vlerësohet inisiativa e KM për kalimin në dispozicion të AKKP, të një sipërfaqeje rreth 23 mijë ha tokë bujqësore dhe 1.4 miliardë lekë, për vitin 2015, me qëllim kompensimin fizik e monetar të ish pronarëve. Edhe ndryshimet që pësoi ligji "Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje", i ndryshuar,¹ kanë lehtësuar mënyrën e pagesës të detyrimit ndaj shtetit. Mbetet problem i pazgjidhur situata e banesave të komunitetit Roma, ose shtetasve me të ardhura të pakta, ndërtimet pa leje të cilëve nuk plotësojnë kriteret e banesës, që parashikon ligji për legalizimet, ndërkohë që për këta shtetas ato ndërtime përbëjnë të vetmen banesë për familjet e tyre. Gjithashtu, kërkon zgjidhje të përshtatshme strehimi i rreth 60 familje të komuniteti Rom dhe Egjiptian, të cilët rrezikojnë të mbeten pa banesa për shkak se nuk mund të përfitojnë nga shpronësimi, sepse nuk disponojnë dokumentacion të rregullt pronësisje, ndonëse jetojnë në ato mjedise prej një kohe të gjatë. Siguria për pronën vazhdon të jetë problematike. Konfliktet lidhur me pronësinë janë të shumta, ato zgjatin me vite, duke bërë të pamundur përdorimin efektiv të pronës. INUK ka ndërmarrë një aktivitet të gjerë për prishjen e ndërtimeve pa leje, me qëllim lirim të hapësirave publike të zëna padrejtësisht, megjithatë nuk kanë munguar rastet kur poseduesit e pasurive kanë pretenduar se disponojnë dokumentacion të rregullt pronësie, i cili nuk është marrë në shqyrtim e verifikim nga Inspektorati Ndërtimor Urbanistik Kombëtar (INUK), përpara se të kryhej prishja. Cenim i të drejtës së pronësisë dhe jetës familjare ka ndodhur nga veprimtaritë private, që zhvillohen pranë vendbanimit të tyre, veçanërisht ato të nxjerrjes e përpunimit të naftës.

Lidhur me lirinë e mediave raporti i organizatës "Freedom House", ka vlerësuar se vendi ynë ka një liri të pjesshme të medias dhe renditet në vendin e 98, mes 197 vendeve të analizuara, duke humbur dy pozicione në këtë renditje. Ndërkohë, vazhdon të ekzistojë problemi i punësimit pa kontratë të gazetarëve dhe ai i mungesës së pavarësisë profesionale të tyre, çka ndikon në

¹ Gazeta Panorama, Datë 03.11.2014, Fq.7



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT

ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

standardedet e medieve dhe në informimin e saktë të publikut. Shprehim shqetësim lidhur me RTSH, si një medie publike, e financuar nga taksapaguesit, e cila duhet të trajtojë më shumë çështje të interesit të gjerë publik, si dhe të zgjerojë bashkëpunimin, pa pagesë, me shoqërinë civile për trajtimin e këtyre çështjeve.

Mirëfunksionimi i sistemit gjyqësor ka qenë një nga prioritetet e punës së KShH, sepse veprimtaria e këtij pushteti është me rëndësi për konsolidimin e shtetit demokratik dhe respektimin e të drejtave dhe lirive të shtetasve. Janë ndërmarrë nisma legjislative dhe organizative, lidhur me këtë pushtet, por ato nuk kanë dhënë rezultate të dukshme. Reforma në drejtësi ka nevojë për konsensus të gjerë parlamentar, por dhe për përfshirje të gjerë të vetë sistemit, sepse kjo reformë nuk mund të kryhet me sukses pa pjesëmarrjen dhe përfshirjen e gjyqtarëve, prokurorëve, avokatëve dhe punonjësve të tjerë të drejtësisë. Gjithashtu duhet hequr dorë nga retorika politike që tenton t'u tregojë gjyqtarëve e prokurorëve se si dhe sa duhet të dënojnë personat që kryejnë shkelje të ligjit.

Sipas Raport-Progressit të BE për Shqipërinë, të Tetorit 2014, “...funksionimi i sistemit gjyqësor në Shqipëri vazhdon të jetë i ndikuar nga politika, sistemi ka llogaridhënie të kufizuar, bashkëpunim të varfër ndër-institucional, ndërkohë që pretendimet për korrupsion brenda sistemit të drejtësisë mbeten një shqetësim serioz.”

Nuk vërehen ndryshime të dukshme lidhur me perceptimin e korrupsionit të pranishëm në veprimtarinë gjyqësore, ashtu dhe përsa i përket shpejtësisë së gjykimit, zvarritjeve të pajustificuara të proceseve gjyqësore, respektimit të afateve për zbardhjen e vendimeve, komunikimit me palët ndërgjyqëse, etj. Vërehet mosrespektim i afateve ligjore nga Gjykatat Administrative, të cilat rezultojnë tepër të mbingarkuara. Probleme manifestohen edhe në drejtim të mënyrës së dhënies së drejtësisë, ku vërehet mungesa e kuptimit dhe zbatimit të unifikuar të legjislacionit në fuqi, gjë që vjen edhe për faktin se Gjykata e Lartë dhe Prokuroria e Përgjithshme, me veprimtarinë e tyre, nuk kanë ndikuar sa duhet në këtë drejtim. Organet përkatëse duhet të gjejnë mekanizma për të përshtatur më mirë shpërndarjen e numrit të gjyqtarëve nëpër gjykata, në përputhje me ngarkesën e tyre, ndërsa KLD duhet të mbikëqyrë dhe të analizojë më mirë këto aspekte të gjyqësorit, duke u ndalur tek gjyqtarët që manifestojnë raste shkeljesh të rënda, ose përsëritura.

Sipas organizatës IDRA, rezulton se 84% e të anketuarve mendojnë se gjyqtarët nuk janë të paanshëm në Shqipëri. Ky është një tregues i krizës së thellë të besimit për gjyqtarët e vendit², pavarësisht se nuk mund t'i paragjykojmë të gjithë në këtë aspekt. 85% të qytetarëve janë shprehur se korrupsioni është “shumë problem”, madje nga 37% e tyre konsiderohet problemi kryesor në vend.³ Rezulton se janë filluar disa procedime nga ana e ILDKP-së për një sërë gjyqtarësh të akuzuar për konsumimin e veprës penale të fshehjes së pasurisë, pastrimit të parave dhe korrupsionit.⁴

Lidhur me ofrimin e shërbimit ligjor falas rezulton se avokatët e caktuar kryesisht nga gjykata dhe prokuroria, për shkak të pagesës së ulët, jo gjithmonë e kryejnë detyrën e mbrojtësit me profesionalizëm të lartë. Problem mbetet fakti që avokatin kryesisht të të pandehurit, pa të ardhura të mjaftueshme, e cakton prokurori i çështjes, i cili nuk është i interesuar që gjatë

² Slide nr49, Draft Raporti mbi pandeshkueshmerine, IDRA

³ Slide nr 9

⁴ Gazeta Panorama/ dt.03.09.2014/ Fq.9; Gazeta Panorama/ dt 17.07.2014/ Fq.2;



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

procesit gjyqësor përkatës, të përballet me një avokat tepër profesional. Shtetasit nuk kanë informacionin e nevojshëm dhe as besimin e duhur në shërbimin e avokatisë të ofruar nga institucionet publike. Ky shërbim nuk funksionon si duhet, nuk është transparent për veprimtarinë që kryen dhe ende nuk ka buxhetin e mjaftueshëm në dispozicion. Mungojnë aktet nënligjore që do të bënin të mundur adresimin e kërkesave pranë këtij institucioni.

Ndihet nevoja që në procesin e gjurmimit dhe hetimit të rriten investimet dhe kapacitetet për të përdorur me mirë provat shkencore dhe për të mos u reduktuar vetëm tek provat me dëshmitarë, të cilat për shkaqe nga më të ndryshmet, në disa raste kanë rezultuar të pamjaftueshme për të provuar fajsinë e të pandehurve. Organi i Prokurorisë duhet të ndërmarrë hetime me nismën e vet, më tepër se deri tani, duke ndjekur me vëmendje shqetësimet që traseton opinionin publik lidhur me shkeljet e ligjit.

Janë rreth 150 shtetas, të cilët në vend që të kurohen, siç ka urdhëruar me vendim gjykata, janë dërguar nga prokurorët ta “*marrin këtë shërbim*” në burg në kundërshtim me ligjin. Është konstatuar, gjithashtu, se organet e prokurorisë zbatojnë praktika të ndryshme për ekzekutimin e këtyre vendimeve gjyqësore. Kemi identifikuar raste të pakta, kur kjo masë mjekësore është ekzekutuar pranë spitaleve psikiatrike, duke shkaktuar kështu dhe diskriminim ndaj shtetasve për shkak të gjendjes së tyre shëndetësore. Duke përshkallëzuar ndërhyrjen tonë rreth kësaj çështje, në Korrik 2014 kemi paraqitur dy kallëzime penale lidhur me këtë situatë.

Monitorimi i situatës së respektimit të të drejtave të personave me liri të kufizuar ka qenë e do të jetë një nga objektet e veprimtarisë së KShH. Mbipopullim ka qenë problemi më i madh i sistemit penitenciar gjatë vitit 2014, i cili ka mbritur në masën rreth 32% më tepër se sa kapaciteti aktual i institucioneve, ndërkohë që në disa institucione paraburgimi mbipopullimi shkon deri në 100% më tepër se kapaciteti i infrastrukturës përkatëse. Situata ka shkaktuar mosrespektim të normës ligjore të hapësirës, që personat me liri të kufizuar duhet të kenë në dispozicion; vendosjen e tyre për të fjetur në tokë dhe me shtresa tejet të konsumuara; vonesa në marrjen e shërbimit shëndetësor, ose ulje e cilësisë së këtij shërbimi; pamundësi për të gëzuar të drejtat, në masën dhe cilësinë e sanksionuar me lig etj. Shkaqe për këtë gjendje janë: zbatimi me përparësi nga ana e gjykatave i masës së sigurimit “Arrest me burg”; zbatimi në masë të ulët i dënimeve alternative të burgimit; tej zgjatja e proceseve gjyqësore; ndërlikimi dhe vështirësimi nga ligji i procedurës për të kërkuar faljen e dënimit; dërgimi i personave me masë mjekësore “*mjekim i detyruar në një institucion shëndetësor*”, në mënyrë të kundraligjshme, për ta vuajtur masën pranë institucioneve të burgimit; ndryshimet e shumta ligjore, që kanë rritur masat e dënimeve penale me burgim, rritja e presionit ndaj institucioneve zbatuese të ligjit, nga politika, për të ashpërsuar masat e sigurimit e të dënimit ndaj veprimeve të paligjshme si, vjedhja e energjisë elektrike, shkelja e rregullave të qarkullimit rrugor, si dhe probleme të administrimit të të burgosurve etj.

Duke përshëndetur iniciativat për vendosjen e ligjëshmërisë në jetën e vendit, shprehim shqetësim lidhur me tendencën për ta parë zgjidhjen tek ashpërsimi i dënimeve me burg, në kushtet kur sistemi ynë penitenciar është i mbipopulluar dhe me shumë mangësi. Mendojmë se janë të nevojshme ndërhyrje në planin legjislativ, organizativ dhe të formimit profesional, për gjyqtarë e prokurorë, që të kuptohet më drejtë qëllimi dhe efektet e masave të sigurimit dhe dënimit me burg, si dhe rëndësia e dënimeve alternative të dënimit me burg. Gjithashtu duhen përdorur më mirë instrumentat ligjorë që ndërpresin vuajtjen e dënimit me burg për personat që plotësojnë kushtet ligjore.



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

Me gjithë përmirësimet e kryera dhe përpjekjet serioze të administratës së Drejtorisë së Prërgjithshme të Burgjeve (DPB) infrastruktura në burgje ka ende probleme të mëdha. Rezultoni prezencë e madhe e lagështirës, mungesë e ndriçimit të mjaftueshëm natyral; mungesë shtretërisht; higjenë e dobët, sidomos në tualete dhe dushe, ose ambiente të përbashkëta; mungesë të shtrojeve; mungesë të mjeteve të higjenës personale dhe të ujit të rrjedhshëm, ose ujit të ngrohtë.

Cilësia e shërbimit shëndetësor është një ndër problemet më të ndjeshme për personat me liri të kufizuar. Në disa raste ekstreme jemi angazhuar për t'i trajtuar këto probleme edhe gjyqësisht, bazuar në argumentimin që u ka bërë Gjykata e Strasburgut rasteve të ngjashme, kundër Shqipërisë e më gjerë, të cilat lidhen me trajtimin çnjerëzor e degradues. Ankesa të shumta kemi marrë edhe lidhur me mungesën e medikamenteve në farmacitë e burgjeve dhe paraburgimeve. Rastet e ushtrimit të dhunës kanë qenë, fatmirësisht, të pakta, por shqetësuese janë rastet e vetëvrasjeve në burgje, të cilat duhen analizuar mirë dhe duhen marrë masa që të parandalohen.

Në lidhje me Policinë e Shtetit rezultoni se është rritur besueshmëria ndaj këtyre organeve. Në studimin e kryer nga Instituti për Zhvillimin e Kërkimeve dhe Alternativave (IDRA) rezultoni se 53 % e tyre shprehet se Policia e Shtetit është institucioni ku besojnë më shumë.

Ka patur një angazhim të madh të strukturave policore në luftën kundër prodhimit dhe trafikimit të lëndëve narkotike dhe ka përpjekje të vazhdueshme për të respektuar më mirë të drejtat e shtetasve, ka një qasje të mirë për hapjen ndaj pritjes dhe dëgjimit të shtetasve, duke përmirësuar ndjeshëm mjediset dhe shërbimin për këtë qëllim. Organet e policisë po bëjnë përpjekje për të qenë transparentë në veprimtarinë e tyre dhe për të bashkëpunuar me qytetarët dhe veçanërisht me organizatat e shoqërisë civile, veçanërisht të atyre që kanë për mision mbrojtjen e lirive dhe të drejtat e njeriut. Megjithatë ka ende disa ambiente të papërshtatshme në polici, ku trajtohen shtetasit, ndërkohë që janë kostatuar dekonspirime të aksioneve të policisë së shtetit, nga pjesëtarë të trupave, çka dëmton rolin, efektivitetin e punës dhe imazhin e këtyre organeve përpara opinionit publik. Mbipopullimin e ambienteve të komisariateve; mungesa e mjedisve të veçanta, në ndonjë rast, për të miturit dhe gratë që trajtohen nga këto organe; mungesë tualetesh në qeli; mungesë krevatesh dhe materialesh të tjera të domosdoshme për jetesë; ankesa lidhur me shkëljen e procedurës mbi njoftimin e të drejtave shtetasve që trajtohen nga policia; ankesa dhe pretendime për keqtrajtim, nga punonjës të policisë; të cilat janë mangësi që krijojnë kushte, që mund të çojnë në trajtim çnjerëzor dhe degradues të shtetasve. Ministria e Brendshme dhe Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm, pas njoftimeve tona kanë patur reagime pozitive. Probleme vërehen edhe në drejtim të garantimit të shërbimit shëndetësor dhe ushqimit të rregullt për personat e shoqëruar/ndaluar/arrestuari. Gjithashtu shqetësues ka qenë bashkëpunimi ndër-institucional, midis Policisë së Shtetit dhe DPB, për të kryer transferimin e personave me masë sigurie "Arrest me burg" nga policia në institucionet e paraburgimit, ose burgimit.

Vërëjme me kënaqësi se investimet e viteve të fundit në Pikat e Kalimit Kufitar kanë krijuar kushte të mira infrastrukturore të këtyre institucioneve, por problem mbetet përkthimi në gjuhën përkatëse për personat që kryejnë kalim të paligjshëm të kufirit. Nga ana tjetër ka patur kërkesa të shumta për azil në vendet të BE-së nga ana e shtetasve shqiptarë, që kanë kaluar kufirin me dokumente të rregullta.

Veprimtaria, gjithnjë në rritje, e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi (KMD), si dhe veprimtarinë e shoqërisë civile në lidhje me këtë temë, kanë bërë të mundur zgjimin e interesit



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

për këtë të drejtë dhe për përdorimin e garancive që ajo ofron. Gjatë vitit 2013 KMD ka marrë 256 ankesa për diskriminim, prej të cilave 17 të paraqitura nga organizata me interesa legjitim dhe 31 çështje i ka marrë në shqyrtim me inisiativë të vet. Në 27% të rasteve të shqyrtuata është konstatuar diskriminim. Aktivë në këtë drejtim janë treguar organizatat që mbrojnë interesat e komuniteti LGBT, të personave me aftësi të kufizuara, të komuniteti Rom, Egjiptian etj.

Zyra e Avokatit të Popullit ka ndërmarrë një sërë nismash dhe ka bërë rekomandime të rëndësishme që tentojnë të përmirësojnë situatën e komunitetit Roma. Megjithatë, nuk është bërë aq sa duhet në këtë drejtim nga organet publike përkatëse. Banorë të Qarkut Lezhë, janë ankuar për diskriminim të fëmijëve të tyre në shkollë, për mungesë akses në tregun e punës, për nevojat e shumta për strehim, etj. Ankesa të ngjashme ka parashtruar edhe komuniteti Roma i qytetit të Korçës, Elbasanit etj.

Lidhur me personat me aftësi të kufizuara, me gjithë shtimin e interesit për ta dhe përmirësimet e kryera, ende ka vonesa, për kryerjen e pagesave që ky komunitet përfiton, në zonat periferike të vendit. Ka probleme me arsimimin e tyre, me ofrimin e shërbimeve mjekësore dhe rehabilituese etj. Ka pasur ankesa dhe pretendime për diskriminim, për shkak të aftësisë së kufizuar, të cilat i janë drejtuar KMD, prej tyre në 6 raste është konstatuar diskriminim.⁵

Lufta kundër korrupsionit dhe sjelljeve abuzive me detyrën mbetet një nga problematikat e rënda që vendi ynë duhet të zgjidhë dhe njëkohësisht një nga detyrat që na është vendosur nga BE në kuadër të integritimit evropian. Zyrtarë të Bashkimi Europian janë shprehur se veçanërisht korrupsioni në gjyqësor është problem shumë serioz në Shqipëri.⁶ Transparency International në raportin e saj të 2014 e renditi Shqipërinë në zonën e kuqe.⁷ Sipas kësaj renditjeje, vendi ynë renditet i fundit në rajon, me problematikë kryesore korrupsionin në sektorin publik. Nga një vështrim krahasues me vitin paraardhës, sipas analizës së Transparency International, Shqipëria rezultoi 6 vende më lartë se vitin e kaluar, në klasifikimin botëror, duke qendruar në vendin e 110, me 33 pikë. Sektorët ku korrupsioni është më evident janë fusha e drejtësisë, sektori i administratës, shëndetësia, arsimi si dhe policia.

Megjithatë 2014 shenoi një kthesë të dukshme në drejtim të goditjes së sjelljeve korruptive dhe të atyre në kundërshtim me detyrën, të kryera nga punonjësit publikë, sepse është rritur ndjeshëm denoncimi dhe marrja nën përgjegjësi penale të këtyre personave, ndërkohë që jemi në pritje të gjykimit dhe dënimit të tyre, si dhe presim që kjo vijë sjelljeje të ndiqet në vazhdimësi. Shqetësues është informacioni që vjen nga mediet për rritjen, me 2.64 herë më shumë, të numrit të veprimeve të dyshuara për pastrim të parave.

Për abuzimet në kompaninë Albpetrol sha⁸, Kontrolli i Lartë i Shtetit (KLSH) ka kallëzuar penalisht disa persona sepse dushohet se kishin krijuar një grup të organizuar kriminal i cili operonte në mënyrë abuzive me fondet, me një dëm kolosal prej disa miliona euro për kompaninë. Vëmendje të gjerë ka shkaktuar skandali i vjedhjes në Bankën e Shqipërisë, ku ish-punonjës të saj janë akuzuar për vjedhjen e një shume rreth 7 milionë dollarë. Në kuadër të hetimeve të zhvilluara janë zbuluara shkelje me procedurat e tenderimit, abuzime me pagesat

⁵ Raporti Vjetor për vitin 2013; "Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi". Fq.29.

⁶ Gazeta Shqip dt 21/05/2014

⁷ Gazeta shqip.com/ Dt. 3.12.2014 <http://gazeta-shqip.com/lajme/2014/12/03/ti-shqiperia-dhe-kosova-ne-zonen-e-kuqe-te-korruptuarat-ne-rajon/>

⁸ Gazeta Panorama/ dt.10.10.2014/ Fq.10



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

dhe djetat e punonjësve, si dhe parregullsi që lidhen me procesin e auditimit të brendshëm të Bankës.⁹

Gjithashtu gjatë 2014 janë vënë nën hetim disa gjyqtarë të niveleve të ndryshme, të cilët janë dyshuar për konsumimin e veprave penale të korrupsionit, shpërdorimit të detyres si dhe pastrim parash. Dyshime për korrupsion ka patur dhe në sistemin shëndetësor, në sektorin e arsimit, ndaj punonjësve të administratës publike të sektorëve të tatim taksave, raste të korrupsionit të punonjësve të ALUIZNI etj.

Mbrojtja e mjedisit ka qenë dhe vazhdon të jetë një nga shqetësimet kryesore në vend. Ai është një faktor që ndikon në të tashmen dhe të ardhmen e jetës së shtetasve. Ka vazhduar investimi i ndërtimit dhe rikonstruksionit të rrugëve nacionale dhe lokale, është rritur kujdesi për të mos lejuar prerjen e paligjshme të pyjeve dhe po bëhen përpjekje për përmirësimin e cilësisë ajrit. Agjensia Europiane e Mjedisit deklaroi se Shqipëria ka ngjitur 13 vende krahasuar me atë të një viti më parë, duke u renditur në vendin e 26-të. Megjithatë problemet janë ende të mëdha në këtë drejtim. Ndotja e ajrit mbetet në parametra të lartë; për grumbullimin e përpunimin e plehrave ende nuk po ndërmerren nisma për zgjidhje bashkohore dhe afatgjata; shtimi i gjelbërimit dhe pyllësimit po ecën me rritje të ulta. Ka raste të ndotjes së mjedisit nga kompani private, me pasoja për shëndetin e banorëve të zonave përreth. I njoftuar për këto shqetësime Instituti i Shëndetit Publik informon se nuk disponon të gjithë mjetet e nevojshme për të analizuar situatën. Mediet flasin për 200 kallëzime penale të bëra nga Ministria e Mjedisit, gjë që tregon se veprimtaria e kundraligjshme që afekton mjedisin ka shtrirje të gjerë.¹⁰ Ndotje e mjedisit shkaktohet dhe nga mbetjet spitalore, të cilat hidhen nëpër lumenj, ose në afërsi të zonave urbane dhe ka raste të ndotjes së mjedisit nga pesticide, mjaft të rrezikshme edhe në zonën turistike (Lukovës në Sarandë¹¹).

Përmbytje ka patur edhe këtë vit dhe disa lumenj dolën nga shtrati¹² por Ministria e Bujqësisë deklaroi se janë ndërmarrë masa për funksionimin e hidrovorëve për largimin e ujit dhe se është pastruar 2000 metra kanal, që nga Ura e Dajlanit e deri në Shkozët të Durrësit, si dhe ka përfunduar argjina mbrojtëse¹³. Me sa duket investimet nuk kanë qenë efikente.

Miratimi i Ligjit të ri, nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit"¹⁴, solli ndryshime pozitive në drejtim të mundësisimit dhe zbatimit të të drejtës së shtetasve për informim. Gjithashtu Ligji nr. 146/2014 "Për njoftimin dhe konsultimin publik" sjell hapjen e institucioneve publike për bashkëpunim me grupet e interesit dhe organizatat e shtetasve në kuadër të hartimit të politikave, strategjive dhe legjislacionit të ri. Parlamenti miratoi, gjithashtu, Ligjin nr. 93/2014 "Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara", Rezolutën "Për njohjen dhe forcimin e rolit të shoqërisë civile në procesin e zhvillimeve demokratike të vendit", ndërsa në muajin Nëntor 2014, KM miratoi vendimin për njohjen e gjuhës së shenjave, si mjet informimi për njerëzit që nuk flasin dhe nuk dëgjojnë. Të gjitha këto akte, hartimi i të cilave është bërë edhe me kontributin e shoqërisë civile, do të kontribuojnë për informimin dhe përfshirjen më të mirë të shtetasve në çështjet publike.

⁹ Gazeta Shqiptarja.com, 23.10.2014/ fq 2; Gazeta Shqip/ dt 17.09.2014/ fq 3; Gazeta Shqip / dt 11.09.2014/ Fq.2; Gazeta Shqip / dt. 12.09.2014/ Fq.3

¹⁰ Gazeta Shqiptarja.com; Datë 05.11.2014, Fq.14.

¹¹ Gazeta Panorama; Datë 17.07.2014, Fq.13.

¹² Gazeta Standard; Datë 23.01.2014, Fq.10

¹³ Gazeta Zëri I Popullit; Datë 23.01.2014, Fq.6.

¹⁴ Gazeta Panorama; Datë 04.09.2014, Fq.4 dhe referuar faqes zyrtare të parlamentit:

http://ëëë.parlament.al/ëëb/pub/ligj_nr_119_dt_18_9_2014_19327_1.pdf



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

KShH dhe shumë organizata të shoqërisë civile kanë kontribuar me vërejtjet e sugjerimet e tyre për ndryshimet në legjislacion. Të tilla përmendim ligjin "Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve dhe të paraburgosurve", Ligjin "Mbi ndihmën juridike", i ndryshuar; Ligjin "Për Policinë e Shtetit"; Ligjin "Për Avokatin e Popullit", i ndryshuar; Ligjin "Kodi i Penal i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar; ligjin "Mbi Policinë e Burgjeve", i ndryshuar; "Për Shërbimin e Kontrollit të Brendshëm në Ministrinë e Drejtësisë"; Ligji "Mbi urgjencën mjekësore", etj.

Megjithatë, rezulton të jenë miratuar, pa u konsultuar me shoqërinë civile dhe grupet e interesit, disa ligje apo akte nënligjore. Jemi të shqetësuar, veçanërisht, për punën e përfunduar dhe jo transparente të kryer në lidhje me ndryshimet në Kodin Zgjedhor, si dhe nuk kanë marrë zhvillim disa propozime për ndryshime ligjore të sugjeruara nga shoqëria civile, si organizatat e personave me aftësi të kufizuara, organizatat e personave LGBT, organizatat e komunitetit Roma etj.

Shqetësim paraqet Urdhëri i Ministrisë së Financave nr. 87, datë 04.11.2014 "Mbi disiplinimin e kryerjes së pagesave të energjisë elektrike nga punonjësit e Ministrisë së Financave dhe institucionet e varësisë". Sipas këtij urdhëri, të gjithë degët e financave të institucioneve janë urdhëruar të mbajnë paratë nga roga për ata punonjës që nuk kanë paguar detyrimet për energjinë elektrike. Punonjësit, të cilët nuk paguajnë detyrimet përkatëse do të marrin vërejtje në Librezën e Punës, ose masa të tjera disiplinore. Kundër këtij Urdhëri ka reaguar Avokati i Popullit, i cili ka kërkuar rishikimin e tij. Sipas këtij institucioni, ky urdhër bie ndesh me parimet bazë në të cilën mbështetet puna e nëpunësve të administratës. Urdhëri është ende në fuqi.

Sugjerohet, gjithashtu, që institucioneve publike, të krijuara për monitorimin dhe mbrojtjen e lirive dhe të drejtave të njeriut, si Avokati i Popullit, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi etj, t'u forcohet më tepër pavarësia institucionale dhe financiare dhe raportet e rekomandimet e tyre të merren në shqyrtim, sa më parë, nga organet ku janë adresuar.

ARRITJE DHE PROBLEME LIDHUR ME RESPEKTIMIN E TË DREJTAVE TË NJERIUT NË VEND

Viti 2014 ka qenë një vit i rëndësishëm për Shqipërinë. Vendi tonë ju dha statusi i vendit kandidat, duke shenjuar kështu një hap tjetër në rrugën tonë të integrimit evropian. Me këtë rast BE i parashtrori vendit për plotësim 5 detyra të rëndësishme të cilat, janë të mbartura nga periudhat e mëparshme të procesit të integrimit. Këto detyra lidhen me luftimin e krimit në përgjithësi dhe atij të organizuar në veçanti; luftimin e fenomenit të korrupsionit; krijimin e një administrate publike të kualifikuar dhe të depolitizuar; përmirësimin e veprimtarisë dhe forcimin e pavarësisë së pushtetit gjyqësor; dhe mbrojtja e të drejtave të njeriut, me fokus të veçantë grupet më të dobta si fëmijët, komunitetin Roma, gratë, personat LGBT, personat me aftësi të kufizuara, ose me liri të kufizuar etj.

Me gjithë situatën e nderë politike që kaloi vendi, për shkak të bojkotit të punimeve të Kuvendit nga ana e opozitës, gjatë këtij viti janë ndërmarrë disa reforma të rëndësishme. Nga zbatimi i tyre janë evidentuar disa arritje, kryesisht në drejtim të përmirësimit të organizimit të pushtetit vendor, forcimit të ligjshmërisë në jetën e vendit dhe luftës kundër korrupsionit. Kjo e fundit



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

nuk është fokusuar vetëm në vënien para përgjegjësisë ligjore të personave të korrumpuar, numri i të cilëve është rritur ndjeshëm, por dhe në marrjen e masave parandaluese në këtë drejtim, si dhe për të luftuar fenomenin e pandëshkueshmërisë në përgjithësi. Hapa të rëndësishëm janë ndërmarrë edhe në drejtim të përmirësimit të mjeteve dhe rrugëve të informimit të publikut, lidhur me veprimtarinë e strukturave të shtetit dhe për ndërtimin e urave të bashkëpunimit me shoqërinë civile. Miratimi i Rezolutës “Për njohjen dhe forcimin e rolit të shoqërisë civile në procesin e zhvillimeve demokratike të vendit”, nga ana e Kuvendit të Shqipërisë, miratimi i ligjit të ri “Për të drejtën e informimit” dhe ligjit “Për njoftimin dhe konsultimin publik” janë një bazë e shëndoshë ligjore për informimin dhe përfshirjen e shtetasve lidhur me çështje të interesit publik. Reforma të rëndësishme kanë filluar e po zbatohen edhe në fushën e arsimit, të shërbimeve sociale dhe të shëndetësisë, të cilat pritet të ndikojnë pozitivisht në respektimin e të drejtave të shtetasve dhe përmirësimin e kushteve të jetesës së tyre.

Pavarësisht rezultateve të përmendura më sipër, gjatë vitit 2014 ka patur dhe mjaft raste të cenimit të lirisë dhe të drejtave të njeriut, në disa drejtime, ose mangësi në drejtim të krijimit të kushteve për gëzimin real të tyre nga shtetasit. Më poshtë prezantojmë disa prej tyre.

1. KRIMINALITETI DHE VEPRIME E MOSVEPRIME QË KANE CENUAR JETËN, SHËNDETIN DHE PASURINË E SHTETASVE

Mbrojtja e jetës dhe shëndetit të shtetasve sanksionohet nga Kushtetuta dhe një sërë dispozitash ligjore. Në këtë drejtim shteti ka detyrë ligjore të tregojë interesim të lartë dhe të veprojë për të ofruar siguri për jetën, duke organizuar një sistem të përshtatshëm për ofrimin e shërbimit shëndetësor, duke përmirësuar e mbikëqyrur qarkullimin e shtetasve në rrugë, duke përmirësuar kushtet e mjedisit dhe duke garantuar tregtimin e ushqimeve dhe mallrave që nuk e dëmtojnë jetën e shëndetin e shtetasve etj. Shteti ka dhe përgjegjësinë të parashikojë dhe ushtrojë një politikë penale dhe administrative në këtë drejtim.

Gjatë vitit 2014 janë miratuar, ose ndryshuar, disa dispozita ligjore që tentojnë të përmirësojnë ofrimin e shërbimit shëndetësor si, ligji “Për Urdhërin e Mjekëve”, ligji “Për Urdhërin e Stomatologut”, ligji “Për Shërbimin e Urgjencës”. Gjithashtu u miratua lista e re e barnave, që do të merren me rimbursim, ku janë shtuar 56 barna të reja. Në fokus të miratimit të kësaj liste kanë qenë fëmijët, gratë shtatzënë, pensionistet, të sëmurët me kancer, sëmundje kardiovaskulare, hepatite, dhe të verbërit. Rezultate pozitive ka patur në drejtim të ndalimit të pirjes së duhanit në mjedise publike, në qytetet e mëdha.

Me gjithë masat e sipërshënuara, si dhe masa të tjera organizative, sektori i shëndetësisë ka ende shumë probleme, të cilat lidhen me korrupsionin, standardet e ulta të shërbimit që ofron, infrastrukturën dhe organizimin. Veçanërisht problematik mbetet shërbimi shëndetësor dytësor, spitalet dhe shërbimet për sëmundjet mendore dhe shërbimi gjinekologjik i abordit, ku ndërprerjet e shtazënisë, mbi bazën e preferencës gjinore të fetusit, përbëjnë jo vetëm shkeje të ligjit, por dhe një fenomen social që duhet luftuar fort, sa më parë.

Nga mediat jemi vënë në dijeni se për vitin 2014, rezulton që shumë spitale dhe klinika publike të vendit janë në gjendje të mjerueshme. Ato kanë mungesë baze materiale, kushte të këqia për fjetjen e pacientëve, lagështirë në ambiente, ndërsa qytetarët shpesh pretendojnë se nuk marrin shërbim mjekësor cilësor.



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

Përtej kushteve që lidhen me infrastrukturën, probleme ka dhe në drejtim të nevojave për personel, kryesisht për mjekë specialistë, në rrethe, gjë që shkakton fluks pacientësh në Tiranë. Bazuar në median e shkruar, Ministri i Shëndetësisë z. Ilir Beqaj, duke pohuar praninë e problemeve, ka premtuar se janë marrë masa që në të ardhmen të mos mungojnë barnat, pajisjet dhe materialet shëndetësore¹⁵. Megjithatë ka vend për të përmirësuar punën dhe shtuar investimet që shërbimi cilësor të mbrijë në të gjitha qendrat e banuara.

Jeta dhe shëndeti i shtetasve janë dëmtuar edhe për shkak të kriminalitetit, i cili gjatë vitit 2014 ka vazhduar të jetë në nivele të larta. Vrasje, kanosje, plagosje, dhuna në familje, shkelje e rregullave të qarkullimit rrugor janë disa nga veprat penale që kanë cenuar jetën e shëndetin e shtetasve. Shkaqet dhe motivet që nxitin këtë lloj kriminaliteti janë të ndryshme si, motive të dobëta, konflikte të pronësisë, gjakmarrje, marrëdhënie konfliktuale midis shtetasve ose në gjirin e familjes etj. Për periudhën Janar-Tetor 2014, sipas të Policisë së Shtetit, janë regjistruar 85 raste vrasjeje si dhe 165 raste të tentativës për vrasje. Statistikat tregojnë një rritje të viktimitave gra nga krimet e vrasjes. Opinioni është tronditur nga disa vrasje, ose vrasje të mbetura në tentativë, ku janë përfshirë persona të njohur si biznesmenë, familjarë politikanësh, punonjës publikë etj., të kryera, në mënyrë të sofistikuar, me armë zjarri, apo eksploziv. Shqetësuese ka qenë, në disa raste, mungesa e sigurisë për jetën dhe shëndetin në mjediset shkollore. Në vrasjet e ndodhura gjatë 2014. Mbizotërojnë vrasjet për motive të dobëta. Kjo situatë është rrjedhojë e mangësive në aktivitetin parandalues por edhe efikasiteti i organeve të policisë, të prokurorisë dhe të gjykatës, në ushtrimin e detyrave dhe kompetencave ligjore përkatëse.

Një rast i rëndë është ai i Tiranës, ku është plagosur me 6 plumba roja i institucionit të shoqërisë civile “strehe” për komunitetin Roma. Drejtuesit e kësaj “strehëze” kanë marrë kërcënime për jetën. KShH, bëri verifikimet përkatëse në terren, duke u takuar me viktimat dhe drejtuesit e policisë të zonës, të cilët na shpieguan se kjo veprimtari kriminale ka në bazë pretendime rreth pronësisë së truallit dhe se tentohet të bëhet presion për zgjidhjen jashtëgjyqësisht të konfliktit, në favor të njerës palë. KShH ka sugjeruar shtimin e patrullimeve të forcave të rendit pranë godinës, ndërkohë që çështja është në hetim nga Prokuroria.

Në drejtim të kontrollit të qarkullimit rrugor organet përkatëse të policisë kanë përmirësuar shërbimin, gjë që ka sjellë rrezultate, megjithatë, deri në fund të Tetorit 2014 ishin regjistruar 1599 aksidente rrugore, që kanë shkaktuar 209 të vdekur, 297 plagosje të rënda dhe 1701 plagosje të lehta. Mediet kanë evidentuar problemin se, në disa raste, vdekjet kanë ardhur si pasojë e mosdhënies së ndihmës në kohën e mënyrën e duhur, gjë që evidenton mungesë formimi në këtë drejtim. Mungesa e respektimit të rregullave të qarkullimit, gjëndja teknike e rrugëve, mungesa e sinjalistikës së duhur janë ndër shkaqet kryesore për vdekjen ose dëmtimin e pasagjerëve dhe këmbësorëve.

Dhuna në familje rezulton, gjithashtu, në nivele të larta, ndërkohë që është rritur ndërgjegjësimi për t’u mbrojtur prej saj dhe për të denoncuar dhunuesin/sen. Në periudhën Janar – Tetor 2014 në Tiranë janë paraqitur 700 kërkesa në gjykatë për të kërkuar urdhër mbrojtjeje, ose 30% më shumë se një vit më parë, ndërkohë që rastet e humbjes së jetës si rezultat i asaj dhune nuk kanë pësuar ulje. Statistikat flasin se 79% e dhunuesve janë meshkuj dhe 21% femra, shifër që tregon se fenomeni i ka prekur të dyja gjinitë. Recitivismi është një tjetër fenomen që lidhet me dhunën në familje, prandaj lind nevoja për gjetjen e mekanizmave me efektivë për të luftuar këtë

¹⁵ Gazeta Shqiptarja.com; Datë 10.09.2014, Fq.7



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

fenomen, si dhe angazhimi më i madh i strukturave publike, krahas ofj-ve që veprojnë me guxim në këtë fushë, për t'u dhënë zgjidhje përfundimtare rasteve që merren në shqyrtim.

Sipas një studimi mbi dhunën ndaj femijëve rezulton se abuzimi i tyre fizik shkaktohet më tepër nga babai. Ajo u shkaktohet në masën 52% fëmijëve djem dhe 48% femrave; ndërsa dhuna emocionale rezulton se është aplikuar në masën 60% ndaj femrave dhe 40% ndaj meshkujve.

Fenomeni i gjakmarrjes ende mbetet problem dhe vazhdon të marrë jetë njerzish. Sipas medias, vetëm në Shkodër rezultojnë zyrtarisht 53 familje të ngujuara për këtë shkak ndërkohë që Komiteti i Pajtitimit Mbarëkombëtar pretendon që numri i të vrarëve për hasmëri të jetë ulur 25 % dhe i vetëvrasjeve për shkak të gjendjes së hasmërisë 50 %. Institucionet publike nuk kanë prezantuar statistika zyrtare rreth shtrirjes së këtij fenomeni, ndërkohë që shumë shtetas, që pretendojnë se janë në një situatë të tillë, kanë kërkuar azil në vende të BE-së, ose më gjerë. Përfaqësues të Misionit Kombëtar të Pajtitimit të Gjajeve kanë kritikuar strukturat publike sepse, sipas tyre, vazhdon të mos veprojnë ndaj këtij fenomeni.¹⁶

Kontrolli i cilësisë së ushqimeve që tregtohen është një tjetër veprimtari që kryen administrata shtetërore për mbrojtjen e shëndetit të shtetasve. Gjatë vitit 2014 u zhvilluan kontrole në këtë drejtim nga AKU. Mjaft tregtarë ambulante u larguan nga trotuarët, në Durrës, për shkak se mallrat e tregtuara nuk plotësonin standartet. I njëjti aksion u ndërmorr edhe në Llogara dhe zonën e Palasës në Vlorë, etj. Kontrole janë ushtruar edhe në Tiranë, ku u konkludua dhe me mbylljen e Tregut tek Uzina Dinamo¹⁷. Ky veprim u shoqërua me protesta nga tregtarët dhe çështja aktualisht i është parashtruar për shqyrtim gjykatës.

Dëmtime të shëndetit kanë ndodhur shpesh në miniera. Në Bulqizë, një minator mbeti i plagosur rëndë nga rënia e inerteve. Një tjetër minator gjeti vdekjen në minierën e Bulqizës, ku pretendohet se ai ka rënë, aksidentalisht, nga një lartësi prej 160 m në tunelin e ashensorit.¹⁸ Disa minatorë të tjerë, që punojnë në një minierë, në Qafë-Mollë të Mirditës, kanë dalë në protestë për kushtet e punës që ofron kompania, pasi në të kanë humbur jetën 3 punëtorë. Megjithatë për të gjitha rastet ka filluar ndjekje penale, është e rëndësishme që dikasteri përkatës të ushtrojë, më shpesh e më mirë, kontroll për kushtet e punës dhe të sigurimit teknik në miniera.

2. RESPEKTIMI I TË DREJTËS SË PRONËS

E drejta e pronës është parë e vlerësuar jo vetëm si një e drejtë subjektive, por dhe si një bazë për zhvillimin ekonomik të vendit. Rritja e sigurisë mbi këtë të drejtë ndikon drejtpërsëdrejti në zhvillimin e ekonomisë së tregut të lirë. Në këtë drejtim KShH vlerëson vendimin e Qeverisë për kalimin në dispozicion të AKKP-së, të një sipërfaqe rreth 23 mijë ha tokë bujqësore dhe 1.4 miliardë lekë, për vitin 2015, me qëllim kompensimin fizik e monetar të ish pronarëve. Megjithatë është e nevojshme që lidhur me detyrimet financiare dhe fizike, që ekzistojnë ndaj ish pronarëve, të bëhet më shumë transparencë dhe të jepet informacion i strukturuar. AKKP të përfundojë sa më parë shqyrtimin e 8340 kërkesave të patrajuara.

¹⁶ Gazeta Panorama; Datë 14.05.2014.

¹⁷ Gazeta Shqiptarja.com; Datë 25.09.2014, Fq.14.

¹⁸ Gazeta Shqip.com; Datë 03.11.2014.



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

Edhe ndryshimet që pësoi ligji "Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje", i ndryshuar,¹⁹ kanë lehtësuar mënyrën e pagesës së detyrimit ndaj shtetit dhe procedurat e pajisjes me çertifikatën e pronësisë, si dhe kanë ulur me 70 % tarifën për hipotekimin e pronës së legalizuar, duke ndihmuar që ky proces të përfundojë sa më parë. Megjithatë mbetet problem i pazgjidhur situata e banesave të komunitetit Roma, ose shtetasve me të ardhura të pakta, ndërtimet pa leje të cilëve nuk plotësojnë kriteret e banesës, që parashikon ligji për legalizimet, ndërkohë që për këta shtetas ato ndërtime përbëjnë të vetmen banesë për familjet e tyre. Strehimi i këtyre shtetasve meriton zgjidhje të përshtatshme ligjore, përpara se t'u prishen mjediset ku banojnë. Shteti duhet të marrë masa ligjore për të evituar diskriminimin e kësaj kategorie në raport me shtetasit e tjerë të cilëve po u legalizohen ndërtimet pa leje.

Vijimi i punimeve për ndërtimin e Unazës së Madhe të Tiranës ka evidentuar problemin e strehimit të rreth 60 familjeve, kryesisht të komuniteti Rom dhe Egjiptian, të cilët rrezikojnë të mbeten pa banesa, për shkak se nuk mund të përfitojnë nga shpronësimi, sepse nuk disponojnë dokumentacion të rregullt pronësie, ndonëse jetojnë në ato mjedise prej një kohe të gjatë. Probleme të tilla hasen edhe në rajone të tjera të vendit. KShH dhe organizata të tjera të shoqërisë civile kanë ndjekur nga afër disa nga këto raste. Disa prej banesave ndonëse ishin në proces legalizimi, ishin paralajmëruar për prishje, pa garantuar strehimin e tyre. Për fat të mirë u arrit të pengohej një veprim i tillë.

Siguria për pronën vazhdon të jetë problematike. Konfliktet lidhur me pronësinë janë të shumta, ato zgjatin me vite, duke bërë të pamundur përdorimin efektiv të pronës. Zyrat e regjistrimit të pasurive të paluejtëshme janë shpesh shkaktare të këtyre konflikteve, për shkak të regjistrimeve të pasakta, që kanë kryer. Në zonat rurale, veçanërisht ato turistike, ende nuk ka përfunduar regjistrimi i pronave, gjë që cenon sigurinë për pronën për personat që i kanë këto pasuri në posedim, për motive të ndryshme ligjore.

GJEDNJ vazhdon të ndëshkojë shtetin shqiptar për shkak të mosekzekutimit të vendimeve të AKKP, për kthimin dhe kompensimin e pronave, ose të vendimeve gjyqësore lidhur me pronat.

Ndërkohë, në muajt e fundit, INUK ka ndërmarrë një aktivitet të gjërë për prishjen e ndërtimeve pa leje, me qëllim lirim të hapësirave publike të zëna padrejtësisht. Megjithatë nuk kanë munguar rastet kur poseduesit e pasurive kanë pretenduar se disponojnë dokumentacion të rregullt pronësie, i cili nuk është marrë në shqyrtim e verifikim nga INUK përpara se të kryhej prishja. KShH çmon se respektimi me rigorozitet i dokumentacionit zyrtar, lidhur me pronësinë, gjatë procesit të shpronësimit për interes publik, ose prishjes së ndërtimeve pa leje, është detyrim i shtetit të së drejtës. Shtimi i kompetencave për këtë strukturë publike, duhet shoqëruar dhe me më shumë vëmendje e kontroll mbi të për respektimin e lirive dhe të drejtave të njeriut.

KShH-së ka marrë ankesa nga grupe shtetasish të ndryshëm, të cilët pretendojnë cenim të të drejtës së pronësisë dhe jetës familjare nga veprimtaritë tregtare që zhvillohen pranë vendbanimit të tyre, veçanërisht ato të nxjerrjes e përpunimit të naftës. Strukturat e shtetit duhet të mbikëqyrin më mirë dhe të parandalojnë ndotjen e mjedisit dhe cenimin e të drejtës së pronësisë nga këto veprimtari.

¹⁹ Gazeta Panorama, Datë 03.11.2014, Fq.7



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

Mjaft shqetësuese paraqitet situata në zonën Belsh të Elbasanit²⁰, ku rreth 4 muaj pas tërmetit, pronarët e shtëpive të dëmtuara dëshirojnë t'i rindërtojnë, ose riparojnë ato dhe kjo gjë nuk u është lejuar. Një prej banorëve, i cili ndërhyri duke restauruar shtëpinë e tij, u procedua nga Prokuroria. Banorët shprehen të shqetësuar duke vënë në dukje se përtej faktit të moskompensimit nga shteti, kërkojnë të paktën të riparojnë shtëpitë e tyre pasi disa prej tyre rrezikohen nga çatitë e dëmtuara. Banorëve u duhet dhënë sa më parë një zgjidhje nga organet kompetente. Kryetari i kësaj Komune ka kërkuar mospenalizimin e këtyre familjeve deri sa të marrin kompensimin në lekë. Edhe në zonën e Cërrikut²¹ banorët e prekur nga një tërmet, më datë 19.05.2014, shprehen të shqetësuar për arsye se janë të pastrehë. Shumë prej tyre jetojnë tek familjarët dhe shprehen se nuk kanë marrë kompensim nga shteti.

3. *LIRIA E MEDIAS*

Liria e medias ka rëndësi të veçantë për një shoqëri demokratike, pasi lidhet ngushtësisht me të drejtën për informim, lirinë e shprehjes dhe të mendimit. Për vitin 2014, raporti i organizatës "Freedom House" konkludon se vendi ynë ka një liri të pjesshme të medias dhe renditet në vendin e 98, mes 197 vendeve të analizuara, duke humbur dy pozicione, në raport me një vit më parë, në këtë renditje.

Kritika në lidhje me pavarësinë e mediave nga politika dhe shkallën e profesionalizmit të tyre kanë parashtruar edhe organizma ndërkombëtare, që monitorojnë vendin tonë, por dhe vetë organizatat e këtij sektori. Ndërkohë, vazhdon të ekzistojë problemi i punësimit pa kontratë të gazetarëve dhe ai i mungesës së pavarësisë profesionale të tyre, çka ndikon në standardet e medieve dhe në informimin e saktë të publikut.

Strukturat publike të fushës së mediave, kanë manifestuar problematika në respektimin e legjislativitetit përkatës. Pushteti politik nuk ka ditur të ndërtojë konsensus legjislativ, ose në drejtim të emërimit të organeve drejtuese të këtyre institucioneve, duke shkaktuar jo vetëm keqfunksionim të tyre, por dhe rënie të standardeve të mbikëqyrjes mbi mediet private, për zbatimin e ligjit në këtë fushë etj.

KShH shpreh shqetësimin se RTSH, si një medie publike, e financuar nga taksapaguesit, duhet të trajtojë çështje të interesit të gjerë publik, më shumë se deri tani, si dhe të zgjerojë bashkëpunimin, pa pagesë, me shoqërinë civile për trajtimin e këtyre çështjeve.

4. *RESPEKTIMI I TË DREJTËS PËR PROCES TË RREGULLT LIGJOR*

Mirëfunksionimi i sistemit gjyqësor ka qenë një nga prioritetet e punës së KShH, sepse veprimtaria e këtij pushteti është me rëndësi themelore për konsolidimin e shtetit demokratik në vendin tonë, si dhe për respektimin e të drejtave dhe lirive të shtetasve. Gjatë vitit 2014 kanë vazhduar të ndërmerren nisma legjislative dhe organizative, lidhur me këtë pushtet, por ato nuk kanë dhënë rezultate të dukshme. KShH është e mendimit se reforma në drejtësi ka nevojë jo vetëm për një konsensus të gjerë parlamentar, por dhe për një përfshirje të gjerë të vetë sistemit sepse, kjo reformë nuk mund të kryhet me sukses pa pjesëmarrjen dhe përfshirjen e gjyqtarëve, prokurorëve, avokatëve dhe punonjësve të tjerë të drejtësisë. Duhet gjetur rrugët dhe mjetet për të përfshirë në këtë proces profesionistët më të mirë dhe me integritet të sistemit, sepse ata nuk

²⁰ Gazeta Shqip; Datë 01.10.2014, Fq.15.

²¹ Gazeta Panorama; Datë 17.06.2014, Fq.13.



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

mungojnë. Duhet hequr dorë nga retorika politike që tenton t'u tregojë gjyqtarëve e prokurorëve se si dhe sa duhet të dënojnë personat që kryejnë shkelje të ligjit, sepse kjo është kompetencë e pushtetit gjyqësor. Të ndërpriten presionet e të gjitha krahëve të politikës për të influencuar mbi veprimtarinë e organeve gjyqësore dhe të Prokurorisë dhe të përdoren më mirë mekanizmat kushtetues për kontrollin midis pushteteve.

Sipas Raport-Progressit të BE për Shqipërinë, të Tetorit 2014, "...*funksionimi i sistemit gjyqësor në Shqipëri vazhdon të jetë i ndikuar nga politika, sistemi ka llogaridhënie të kufizuar, bashkëpunim të varfër ndër-institucional, ndërkohë që pretendimet për korrupsion brenda sistemit të drejtësisë mbeten një shqetësim serioz.*"

Nga studimi i organizatës IDRA, me fokus perceptimin e shtetasve mbi gjyqësorin, rezulton se 84% e të anketuarve mendojnë se gjyqtarët nuk janë të paanshëm në Shqipëri, duke shprehur kështu krizën e thellë të besimit për ta²².

a. Kohëzgjatja e proceseve gjyqësore

Kohëzgjatja e proceseve civile dhe penale ka pësuar përmirësim në gjykatat e zakonshme, por vërehet mosrespektim i afateve ligjore nga Gjykatat Administrative, të cilat rezultojnë tepër të mbingarkuara. Zvarritja e proceseve, tej afatave të arsyeshme, vazhdon të jetë karakteristike e gjykatave shqiptare, çka sjell reduktim të ndjeshëm të efektivitetit të sistemit, sepse drejtësia e vonuar është drejtësi e munguar, shprehet GJEDNJ. Gjatë këtij viti ra në sy të opinionit procesi gjyqësor ndaj të pandehurit Dritan Dajti²³, ku shtyrjet e shumta të seancave gjyqësore, të shkaktuara nga mungesa e avokatëve mbrojtës, bllokuan gjykimin, duke treguar paaftësinë e sistemit për t'u përballur me deformime të tilla. Gjykimi përfundoi, në Gjykatën e Shkallës së Parë të Krimeve të Rënda, pas 276 seancash gjyqësore, me dënimin me burgim të përjetshëm për të pandehurin.

Raste të tjera flagrante janë ai i një shtetasi amerikan, të cilit i është dashur të ndjekë 65 seanca gjyqësore për pjestimin e pasurisë,²⁴ ose rasti tjetër ku për shqyrtimin e një konflikti për legalizimin e një objekti janë nevojitur pesë vite.²⁵

b. Korrupsioni në sistemin gjyqësor dhe probleme të ushtrimit të funksioneve

Bazuar në studimin e lartpërmendur të IDRA-s, 85% të qytetarëve janë shprehur se korrupsioni është "*shumë problem*", madje konsiderohet problemi kryesor në vend nga 37% e tyre.²⁶ Nga ana tjetër, sipas portalit të Ministrisë së Drejtësisë, këtë vit ka pasur mbi 700 ankesa nga qytetarë për shkelje të pretenduara ndaj gjyqtarëve dhe prokurorëve.²⁷ Rezulton se janë filluar disa procedime nga ana e ILDKP-së për një sërë gjyqtarësh të akuzuar për konsumimin e veprës penale të fshehjes së pasurisë, pastrimit të parave dhe korrupsionit.²⁸ Lidhur me këtë vepër penale, një gjyqtar i Gjykatës së Shkallës së Parë Pogradec u arrestua dhe u gjykua për ryshfet, ndërsa ish kryetari i Gjykatës së rrethit Gjyqësor Pukë dhe ish-prokurori i Prokurorisë së Rrethit

²² Slide nr49, Draft Raporti mbi pandeshkueshmerine, IDRA

²³ Gazeta Shqip/ dt 29.05.2014/ Fq.5

²⁴ Gazeta Shqip / 14.01.2014 / Fq. 4

²⁵ Gazeta Shqiptarja/ dt 26.08.2014/

²⁶ Slide nr 9

²⁷ Gazeta Shqiptarja.com / dt 20.03.2014 / Fq. 7

²⁸ Gazeta Panorama/ dt.03.09.2014/ Fq.9; Gazeta Panorama/ dt 17.07.2014/ Fq.2;



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

Pukë janë të vetmit zyrtarë të këtij rangu të proceduar penalisht me akuzën "korrupsion pasiv". Duket qartë se reagimi i organeve përkatëse, ndaj këtij fenomeni negativ në drejtësi, është ende i pakët dhe nuk i përgjigjet vlerësimit që vjen nga publiku, nga organizmat ndërkombëtare dhe nga pushtetet e tjera të vendit.

Nga monitorimet dhe studimet e ndërmarra nga KShH ka rezultuar se në sistemin e drejtësisë, gjatë këtij viti, nuk vërehen përmirësime të dukshme, si përsa i përket perceptimit të korrupsionit të pranishëm në veprimtarinë e tij, ashtu dhe përsa i përket shpejtësisë së gjykimit, zvarritjeve të pajustificuara të proceseve gjyqësore, respektimit të afateve për zbardhjen e vendimeve, komunikimit me palët ndërgjyqëse etj. Nuk kanë munguar as raste flagrante të mungesës së integritetit nga ana e ndonjë gjyqtari, prokurori apo avokati. Probleme manifestohen edhe në drejtim të mënyrës së dhënies së drejtësisë, ku vërehet mungesa e kuptimit dhe zbatimit të unifikuar të legjislacionit në fuqi, që përveç të tjerave, vjen edhe për faktin se Gjykata e Lartë, ose Prokuroria e Përgjithshme, me veprimtarinë e tyre nuk kanë ndikuar sa duhet në këtë drejtim.

Niveli profesional i gjyqtarëve, vihet në diskutim edhe për faktin se janë të shumta vendimet e prishura nga gjykatat e nivelit më të lartë. Këtë shqetësim e kanë ngritur edhe mediet, duke cituar se gjykatat e Apelit kanë një praktikë të gjerë të prishjes së vendimeve të gjykatave të shkallës së parë.²⁹

Për këto shqetësime KShH është prononcuar nëpërmjet disa deklaratave për shtyp. Mendojmë se organet përkatëse duhet të gjejnë mekanizma për të përshtatur më mirë shpërndarjen e numrit të gjyqtarëve nëpër gjykata, në përputhje me ngarkesën e tyre, ndërsa KLD duhet të mbikëqyrë dhe të analizojë më mirë këto aspekte të veprimtarisë së gjykatave, duke u ndalur tek gjyqtarët që manifestojnë raste të tilla të rënda ose të përsëritura, në përputhje me ligjin.

c. Shërbimi ligjor falas.

E drejta për t'u mbrojtur me avokat, në një proces gjyqësor penal e civil, është pjesë e rëndësishme e të drejtës për proces të rregullt ligjor, por referuar problematikave që na kanë adresuar shtetas të ndryshëm dhe verifikimeve të kryera nga organizata jonë, rezultojnë se mjaft shtetas nuk janë në gjendje të përballojnë kostot për të marrë ndihmën ligjore, që ofron avokatia si shërbim profesional privat. KSHH dhe disa ofj të tjera kanë ndihmuar në këtë drejtim, brenda mundësive që ju janë krijuar nga donatorë të ndryshëm ndërkombëtarë, kryesisht CRD, por kjo nuk ka qenë e mjaftueshme. Nga ana tjetër rezultojnë se avokatët e caktuar kryesisht nga gjykata dhe prokuroria, për shkak të pagesës së ulët që përfitojnë për punën e tyre, jo gjithmonë e kryejnë detyrën e mbrojtësit me profesionalizëm të lartë dhe efikasitet. Problem mbetet fakti që avokatin kryesisht të të pandehurit, pa të ardhura të mjaftueshme, e cakton prokurori i çështjes, i cili nuk është i interesuar që të përballlet me një avokat tepër profesional gjatë procesit gjyqësor përkatës. Në këtë drejtim i duhet dhënë më tepër rëndësi njoftimit të të pandehurit për të drejtën e garantuar për të patur një avokat falas dhe të mrrëdhënieve që duhet të ketë me mbrojtësin e tij.

Përsa i përket shërbimit ligjor falas, që duhet ofruar nga strukturat publike pranë Ministrisë së Drejtësisë, bazuar në ligjin nr. 10 039, dt. 22.12.2008, "Mbi ndihmën juridike", i ndryshuar,

²⁹ Gazeta Panorama/ dt.17.07.2014/ Fq.10; Dt. 19.03.2014 / Fq.13; Dt. 10. 03.2014; Gazeta Shqiptarja/ 07.03.2014/ Fq 6;



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

konstatohet se shtetasit nuk kanë informacionin e nevojshëm dhe as besimin e duhur në këtë shërbim. Ky shërbim nuk funksionon si duhet, që nga koha e krijimit, nuk është transparent për veprimtarinë që kryen dhe ende nuk ka buxhetin e mjaftueshëm në dispozicion, në raport me nevojat e shumta të shtetasve të varfër, për të ofruar shërbimin ligjor falas. Mungojnë aktet nënligjore që do të bënin të mundur adresimin e kërkesave pranë këtij institucioni.

d. Mbrojtja e të drejtave nga organet e procedimit penal

Misioni i organeve të prokurorisë, në thelb, është të ushtrojë ndjekjen penale dhe përfaqësimi akuzën në gjykim, në emër të shtetit. Një rol të veçantë kanë këto organe dhe për ekzekutimin e vendimeve penale. Për pasojë pritet që veprimtaria e organeve të Prokurorisë, në bashkëpunim me organe të tjera, të ngarkuara me ligj, të ndikojë në zbulimin dhe ndëshkimin në kohë të kriminalitetit dhe në uljen e tij, për t'i ofruar shoqërisë më shumë siguri, besueshmëri ndaj shtetit të së drejtës.

Gjatë vitit 2014, Prokurorisë i është dashur të hetojë për disa çështje tepër sensitive, disa prej të cilave kanë qenë komplekse. I referohemi rasteve të vrasjeve të biznesmenëve të ndërtimit, vrasjes së bankierit A.S, vjedhjes masive në Bankën e Shtetit, hetimi për korrupsion i disa ish-zyrtarëve me profil të lartë, përfshirë ish funksionarë të KLD-së, etj. Ndihet nevoja që në procesin e gjurmimit dhe hetimit të rriten investimet dhe kapacitetet për të përdorur me mirë provat shkencore dhe për të mos u reduktuar vetëm tek provat me dëshmitarë, të cilat për shkaqe nga më të ndryshmet, në disa raste kanë rezultuar të pamjaftueshme për të provuar fajsinë e të pandehurve. Megjithatë sipas studimit të publikuar nga KShH, në vitin e kaluar, rezulton se këto organe duhet të punojnë më shumë për të rritur efektivitetin e veprimtarisë së tyre, veçanërisht shpejtësinë, objektivitetin dhe gjithanshmërinë e hetimit për veprat e denoncuar, pa diferencuar çështjet në të "vogla" nga ato me sensibilitet të lartë në opinion. Këto organe duhet të ndërmarrin hetime me nismën e tyre, më tepër se deri tani, duke ndjekur me vëmendje shqetësimet që traset opinionin publik lidhur me shkeljet e ligjit. Shtetasit kanë të drejtë të denoncojnë shkeljet ligjore që konstatohen, por aktivizmi i tyre mund të bjerë, nëse organet e prokurorisë nuk i vlerësojnë ato maksimalisht, sipas ligjit dhe kompetencave që kanë.

Një nga çështjet që po ndjek KShH, prej vitesh, është mënyra e kundraligjshme e ekzekutimit të vendimeve gjyqësore për caktimin e masës "mjekim i detyruar në institucion mjekësor" nga organet e prokurorisë. Janë rreth 150 shtetas, të cilët në vend që të kurohen, siç ka urdhëruar gjykata, janë dërguar ta "marrin këtë shërbim" në burg. Mbajtja e tyre në sistemin e burgjeve, në mungesë të trajtimit shëndetësor të përshtatshëm, krijon kushte për trajtimin çnjerëzor dhe poshtërues të tyre, të ndaluar kategorikisht nga neni 25 i Kushtetutës dhe neni 3 i KEDNJ. Pretendimi i organeve të prokurorisë se pranë sistemit shëndetësor publik mungon institucioni i posaçëm, që përshkruan ligji për këtë qëllim, nuk justifikon cenimin flagrant dhe të shumëfishtë të të drejtave të këtyre shtetasve të sëmurë si, e drejta për liri personale, e drejta e mbrojtjes, zotësia për të vepruar dhe e drejta për kujdes shëndetësor, të garantuara gjithashtu nga Kushtetuta. Megjithatë, nga monitorimi i kryer nga KShH është konstatuar se organet e prokurorisë zbatojnë praktika të ndryshme për ekzekutimin e këtyre vendimeve gjyqësore sepse ndërkohë janë identifikuar raste të pakta kur kjo masë mjekësore është ekzekutuar pranë spitaleve psikiatrike, duke shkaktuar kështu diskriminim ndaj shtetasve për shkak të gjendjes së tyre shëndetësore.

Duke përshkallëzuar ndërhyrjen tonë rreth kësaj çështjeje, që po e ndjekim prej vitesh, në kushtet e një mungese reagimi nga organet përkatëse, në Korrik 2014 kemi paraqitur dy



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

kallëzime penale ndaj punonjësit të Prokurorisë Tiranë, që vepron për ekzekutimin e vendimeve si dhe ndaj drejtuesit të Institutit të Veçantë Shëndetësor të Burgjeve, përkatësisht për veprat penale “Shpërdorim i detyrës”, ”Mbajtje në burg pa vendim”, të cilat do t’i ndjekim me konsekuencë, duke ezauruar të gjitha mjetet ligjore, që parashikohen për mbrojtjen e të drejtave të këtyre shtetasve.

5. RESPEKTIMI I TË DREJTAVE TË PERSONAVE TË PRIVUAR NGA LIRIA NË INSTITUCIONET PENITENCIARE

Vëzhgimi i situatës së respektimit të të drejtave të personave me liri të kufizuar ka qenë e do të jetë një nga objektet e veprimtarisë së KShH, sepse të qenët me liri të kufizuar shton riskun e cenimit të të drejtave të tyre. Për këtë arsye sistemi penitenciar është monitoruar gjerësisht, gjatë këtij viti edhe nga Avokati i Popullit, nga KShH e organizata të tjera të shoqërisë civile. Në këtë aspekt vlen të përgëzohen drejtuesit e këtij sistemi të cilët kanë koncepte të drejta në drejtim të monitorimit nga jashtë të veprimtarisë që zhvillohet në institucionet e tyre. Ata duhen falënderuar për mirëkuptimin dhe bashkëpunimin në këtë drejtim.

Gjithashtu për veprimtarinë e vitit 2014 duhen evidentuar, si pozitive, investimet për ndërtimin e institucioneve të reja në Berat, Shkodër e Tropojë, ose për të mbyllur IP Kukës, si dhe për të sistemuar disa kategori të paraburgosurve, të mitur dhe gra në mjedise më të përshtatshme në Tiranë.

Megjithatë, nga misionet e monitorimit, që KShH ka realizuar këtë vit në sistemin shqiptar të burgjeve dhe paraburgimeve ka rezultuar se ka problematika të qënësishme përsa i takon kushteve të jetesës, të ndikuara edhe nga mipopullimi i lartë, si dhe mungesa e mjeteve financiare e materiale të mjaftueshme për të përballuar nevojat.

a. Mbipopullimi

Mbipopullimi ka qenë problemi më i madh i sistemit penitenciar, gjatë vitit 2014, i cili ka mbritur në masën rreth 32% më tepër se sa kapaciteti aktual i institucioneve, ndërkohë që në disa institucione paraburgimi mbipopullimi shkon deri në 100% më tepër se kapaciteti i infrastrukturës përkatëse. Situata e mbipopullimit ka shkaktuar: mosrespektim të normës ligjore të hapësirës, që personat me liri të kufizuar duhet të kenë në dispozicion; vendosjen e tyre për të fjetur në tokë dhe me shtresa tejet të konsumuara; vonesa në marrjen e shërbimit shëndetësor, ose ulje e cilësisë së këtij shërbimi; pamundësi për të gëzuar të drejtat, në masën dhe cilësinë e sanksionuar me ligj, si p.sh përdorimin e banjave, dusheve, mjediseve të ajrimit, pjesëmarrjen në aktivitete sportive-argëtuese dhe në ato me karakter social, si dhe në drejtim të përfitimit të lejeve. Nuk kanë munguar as rastet ekstreme, kur për shkak të mbipopullimit, të burgosurit nuk kanë krevat personal, ose kur janë përdorur si mjedise për fjetjeje edhe ambiente të papërshtatshme për këtë qëllim dhe ku të dënuarit detyrohen të kryejnë nevojat e tyre në kova, sepse nuk kanë tualet në dhomë.

Ligjit Nr. 22/2014, dt. 10.03.2014, ”Për dhënie aministie”, pati efekt në reduktimin popullatës në burgje, por fenomeni i mbipopullimit mbeti ende problem për shkak të zbatimit me përparësi, nga ana e gjykatave, të masës së sigurimit “Arrest me burg”; zbatimit në masë të ulët i dënimeve alternative të burgimit; tej zgjatja e proceseve gjyqësore; ndërlikimi dhe vështirësimi, nga ndryshimet ligjore, i procedurës për të kërkuar faljen e dënimit; dërgimi, në mënyrë të kundraligjshme, i personave me masë mjekësore ”mjekim i detyruar në një institucion



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

shëndetësor” për ta vuajtur masën pranë institucioneve të burgimit; probleme të administrimit të të burgosurve dhe paraburgosurve nga DPB. Shkak tjetër janë ndryshimet e shumta ligjore, të viteve të fundit, që kanë rritur masat e dënimeve penale, si dhe rritja e presionit ndaj institucioneve zbatuese të ligjit, për të ashpërsuar masat e sigurimit e të dënimit ndaj veprimeve të paligjshme si, vjedhja e energjisë elektrike, shkelja e rregullave të qarkullimit rrugor, duke aplikuar arrestimin dhe burgimin etj.

KShH ka vërejtur se, pas iniciativës që ka ndërmarrë qeveria për vjeljen e pagesave të prapambetura për energjinë elektrike të konsumuar, rezulton të jenë proceduar penalisht shumë shtetas për të cilët është dhënë masa e sigurimit ”Arrest me burg”, ndonëse neni 137 i Kodit Penal parashikon se lidhja e paligjshme me rrjetin e energjisë elektrike përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim gjer në dy vjet, ndërsa vjedhja e energjisë elektrike dënohet me gjobë ose me burgim gjer në tre vjet. Tendenca për ashpërsimin e dënimeve penale vihet re edhe në iniciativat ligjore të ndërmarra nga qeveria, e cila propozon ndryshime në Nenin 199/a, të Kodit Penal³⁰, me qëllim që personat që kryejnë ndërtime pa leje, ose vepron në tejkallim të saj, të dënohen me burg deri në 8 vjet, ndërkohë që dispozita aktuale parashikonte dënim deri 1 vit burg. Projekt-dispozita e shtrin përgjegjësinë penale edhe mbi sipërmarrësin, mbikqyrësin dhe zbatuesin e punimeve. KShH, duke përshëndetur iniciativat për vendosjen e ligjëshmërisë në jetën e vendit, ka shprehur shqetësim lidhur me tendencën për ta parë zgjidhjen tek ashpërsimi i dënimeve me burg, në kushtet kur sistemi ynë penitenciar është i mbipopulluar, e me shumë mangësi e probleme. Nga ana tjetër prekja e masave të ndëshkimit, që parashikon Kodi Penal, pa një studim të tërësor të politikës penale që përmban ky Kod, prish raportet e masave të dënimit që parashikohen dhe që janë vendosur duke mbajtur parasysh rrezikshmërinë shoqërore të veprave penale, pasojat, si dhe rrezikshmërinë e subjekteve që i kryejnë ato.

KShH mendon se janë të nevojshme ndërhyrje në planin legjislativ, organizativ dhe të formimit profesional për gjyqtarë e prokurorë, që të kuptohet më drejtë qëllimi dhe efektet e masave të sigurimit dhe dënimit me burg, si dhe rëndësia e dënimeve alternative të dënimit me burg. Gjithashtu duhen përdorur më mirë instrumentat ligjorë që ndërpresin vuajtjen e dënimit me burg për personat që plotësojnë kushtet ligjore. Kjo jo thjeshtë sepse duhet të pakësojmë mbipopullimin dhe shpenzimet buxhetore në këtë drejtim, por edhe sepse kjo është pjesë e konceptit të dënimit penal në një shoqëri demokratike.

b. Infrastruktura dhe kushtet e jetesës

Me gjithë përmirësimet e kryera dhe përpjekjet e administratës së DPB infrastruktura në burgje ka ende probleme të mëdha, të cilat janë më evidente në disa institucione të vjetra, të trashëguara nga sistemi i kaluar. Rezulton prezencë e madhe e lagështirës, mungesë e ndriçimit të mjaftueshëm natyral; mungesë shtretërishe; higjenë e dobët, sidomos në tualete dhe dushe, ose ambiente të përbashkëta; mungesë të shtrojeve; mungesë të mjeteve të higjenes personale dhe të ujit të rrjedhshëm, ose ujit të ngrohtë; mungesa e ambienteve të përshtatshme për ajrim në kohë reshesh, etj. Këto mangësi shkaktojnë cenim të të drejtave të sanksionuara me ligj për këta persona.

c. Shërbimi Psiko-Social

³⁰ Referuar faqes zyrtare të Paralemenitit të Shqipërisë:

file:///C:/Documents%20and%20Settings/User/My%20Documents/Doenloads/pligtj_ndryshim_7895_kodi_penal.pdf



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

Sigurimi i shërbimit psikosocial është një tjetër e drejtë që kanë shtetasit e paraburgosur/të dënuar, gjatë qëndrimit në institucionet penitenciare, i cili realizohet nëpërmjet organizimit të aktiviteteve të përcaktuara për këtë qëllim dhe që i shërbejnë riedukimit të tyre. Individualizimi i mënyrës së vuajtjes së dënimit³¹ është një tjetër e drejtë ligjore e cila përmbush kuadrin e trajtimit që duhet ofruar në këto institucione. Vëzhgimet kanë treguar se këto të drejta³² zbatohen pjesërisht në institucionet penitenciare, përveç IEVP “Ali Demi” Tiranë dhe Institucionit të Veçantë për të Miturit në Kavajë, ku ofrohen programe të larmishme dhe me nivel profesional. Është konstatuar se personelit të shërbimit psiko-social i IEVP-ve, në të gjithë vendin, u mungojnë burimet financiare, materiale dhe ambientet e përshtatshme për të përmbushur detyrimet ligjore, në favor të personave me liri të kufizuar, gjë që ndikon negativisht në procesin e riedukimit të tyre.

d. Shërbimi Shëndetësor

Cilësia e shërbimit shëndetësor është një ndër problemet më të ndjeshme për personat me liri të kufizuar. Gjatë 2014 KShH ka marrë ankesa të shumta në këtë drejtim. Në disa raste ekstreme jemi angazhuar për t'i trajtuar këto probleme gjyqësisht, në aspektin e trajtimit çnjerëzor e degradues, bazuar në argumentimin që u ka bërë GJEDNJ rasteve të ngjashme, kundër Shqipërisë e më gjerë.

Janë evidentuar raste kur të burgosurve u mohohet kurimi me ndërhyrje kirurgjikale, për shkak të mungesës së mjeteve. Për personat me liri të kufizuar shteti ka barën dhe përgjegjësinë të sigurojë të gjitha mjetet e nevojshme për t'u ofruar shërbimin shëndetësor, pa diskriminim, kësaj kategorie personash.

Ankesa të shumta kemi marrë dhe lidhur me mungesën e medikamenteve në farmacitë e IEVP-ve, apo për vonesat në furnizimin me medikamente për diagnoza të ndryshme mjekësore, veçanërisht për rastet e sëmundjeve që nuk mbulojnë nga skema e rimbursimit. Shkaku kryesor i këtij problemi është buxheti i pakët që kanë institucionet e sistemit penenciar për këtë qëllim (rreth është 10.000 lekë në vit), por dhe menaxhimi jo i mirë i tyre.

Bazuar në nenin 55/1 të Kushtetutës, në të cilën sanksionohet se “shtetasit gëzojnë në mënyrë të barabartë të drejtën për kujdes shëndetësor nga shteti” dhe nisur nga fakti se përgjegjësinë dhe kompetencat për këtë shërbim e ka Ministria e Drejtësisë, sugjerojmë që kjo Ministri duhet të shtrijë mbikëqyrjen e saj edhe mbi shërbimin shëndetësor në sistemin e burgjeve.

e. Rastet e ushtrimit të dhunës

Rastet e ushtrimit të dhunës kanë qenë, fatmirësisht, të pakta. Megjithatë, në IEVP Vlorë, IEVP Burrel, IEVP Korçë, etj., kemi marrë ankesa nga të dënuar për ushtrim dhune nga stafi i institucionit. Duke qenë tepër të vëmendshëm ndaj sjelljeve të tilla, këto ankesa ua kemi referuar organeve përkatëse, prej të cilave kemi marrë, shpesh, njoftime rreth masave të marra të

³¹ Sipas nenit 10 të Ligjit nr. 8328, datë 16.04.1998, ndryshimi nr. 40/2014, “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”.

³² Vecanërisht në përmbushje të nenit 32 të ligjit “...Objektivat e trajtimit psiko-social synojnë zhvillimin e aftësive e të shprehive individuale për t'u riintegruar në shoqëri, nëpërmjet përfshirjes së të paraburgosurve dhe të dënuarve në programet e arsimit, formimit profesional, punësimit, veprimtarive kulturore, sportive, këshillimin psikologjik e social”



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

cilat shkojnë deri në pezullimin nga detyra të punonjësit dhunues (IEVP Vlorë). Gjithashtu, shqetësuese janë rastet e vetëvrasjeve në burgje, të cilat duhen analizuar mirë dhe duhen marrë masa që të parandalohen më mirë në të ardhmen. Në këtë drejtim një rol të veçantë ka shërbimi shëndetësor dhe psikosocial i burgjeve, të cilët mund të ndihmojnë në parandalimin e fenomeneve të tilla, por të ndihmojnë, gjithashtu, në evidentimin e rasteve të dhunës, në se pasqyrojnë qartë e saktë gjendjen shëndetësore e psiqike të të burgosurve. Për këtë duhet punuar më shumë për rritjen e kapaciteteve dhe pavarësisë profesionale të këtyre nëpunësve të burgjeve.

f. Mbajtja e personave në veçim

Politika disiplinore³³ që zbatohet në institucionet penitenciare ka patur një vëmendje të veçantë të vëzhgimeve të KShH-së në institucionet penitenciare. Zbatimi i kësaj politike lidhet me disiplinimin e sjelljeve të të burgosurve dhe paraburgosurve, shkelja e të cilave sjell pasoja ligjore për ta, por dhe me riedukimin e tyre. Për këtë arsye merr rëndësi fakti që zbatimi i këtyre procedurave të drejtë dhe në përputhje me standardin ligjor e profesional.

Në krahasim me vitin e kaluar, ka një përmirësim të zbatimit të kësaj procedure. Nuk është vërejtur përdorimi i ambientit të veçimit, pa qënë pjesë e procedurës disiplinore, me përjashtim të disa rasteve ekstreme. Dhënia e masave disiplinore përdoret si mjet i fundit, gjë që është për t'u vlerësuar pozitivisht. Megjithatë ka nevojë që të përmirësohen kushtet e dhomave të veçimit, gjendja e të cilave, në disa raste, mund të shkaktojë trajtim çnjerëzor e degradues³⁴ të personave që izolojnë në to. Gjithashtu, duhet kufizuar përdorimi i ambienteve të veçimit për arsye jo disiplinore³⁵, i cili duhet të realizohet gjithmonë në përputhje me standardet e Komitetit për Parandalimin e Torturës.

6. RESPEKTIMI I LIRIVE DHE TË DREJTAVE PËR SHTETASVE QË TRAJTOHEN NGA ORGANET E POLICISË SË SHTETIT

Institucioni i Policisë së Shtetit ka zhvilluar një veprimtari të gjerë gjatë vitit 2014 si për shkak të ndryshimeve legjislativë, që kanë zgjeruar gamën e përgjegjësisë të këtyre organeve, por dhe për shkak të rritjes së përpjekjeve për luftimin e kriminalitetit, veçanërisht atij të organizuar. Si pasojë është rritur besueshmëria ndaj këtyre organeve. Në studimin e kryer nga IDRA rezultoi se 53 % e tyre shprehet se Policia e Shtetit është institucioni ku besojnë më shumë.

Në mënyrë të veçantë, gjatë vitit 2014, u vu re një angazhim i madh i strukturave policore në luftën kundër prodhimit dhe trafikimit të lëndëve narkotike, aksionet e të cilës kulmuan në ndërhyrjet masive dhe të organizuara në fshatin Lazarat dhe të Malësisë së Madhe, etj. Opinioni publik, vendas dhe ai ndërkombëtar, kanë mirëpritur këtë veprimtari dhe rezultatet e aksioneve të policisë në këtë drejtim. Këto operacione, që duhet të kenë vazhdimësi, kanë mundësuar dhe vënien e përpara përgjegjësisë penale, si/dhe arrestimin e personave që i kryenin këto veprimtari të kundraligjshme. Është vërejtur se po bëhen përpjekje për të respektuar më mirë të drejtat e shtetasve, duke mbyllur shumë prej ambienteve të papërshtatshme, që policia ka patur në dispozicion për vendosjen e shtetasve që trajton, kryesisht ato për mbajtjen e personave të

³³ Nenet 51-54 të ligjit sipërcituar.

³⁴ Sic ishin dhomat e veçimit të IEVP Rrogozhinë etj..

³⁵ Shpesh, dhomat e veçimit përdoren edhe për të dënuar me papërshtatshmëri në sektorët e tjerë të institucioneve penitenciare.



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

ndaluar. Gjithashtu, ka një qasje për hapjen ndaj pritjes dhe dëgjimit të shtetasve, duke përmirësuar ndjeshëm mjediset dhe shërbimin për këtë qëllim.

Organet e policisë së shtetit po bëjnë përpjekje për të qenë më transparente në veprimtarinë e tyre dhe për të bashkëpunuar me qytetarët dhe veçanërisht me organizatat e shoqërisë civile, veçanërisht të atyre që kanë për mision mbrojtjen e lirive dhe të drejtat e njeriut. Ato janë treguar të hapura dhe bashkëpunuese në drejtim të përmirësimit të standardeve të respektimit të këtyre të drejtave, si dhe për kualifikimin e stafeve të tyre në këtë drejtim.

Organet e policisë po luftojnë shfaqet korruptive në gjirin e punonjësve të tyre. Prej tyre u pretendua se korrupsioni është luftuar me 63% më shumë gjatë 2014-tës³⁶, por të dhënat tregojnë se korrupsioni është ende prezent në strukturat policore. Shunë punonjës policie janë kallëzuar penalisht për veprën penale të korrupsionit, për falsifikime të bëra në shkëmbim të parave, etj.³⁷ Tentativat e shtetasve për t'u ofruar rryshfet efektivave të rendit apo qarkullimit rrugor janë denoncuar, në disa raste, duke i proceduar ata me këtë akuzë.³⁸

Megjithatë janë kostatuar dhe probleme në mirëfunksionimin e organeve policore, si rastet e dekonspirimit të aksioneve të policisë së shtetit nga pjesëtarë të trupave, çka dëmton rolin, efektivitetin e punës dhe imazhin e këtyre organeve përpara opinionit publik. Probleme ka patur dhe në drejtime të tjera, të cilat po i përmendim në vijim, në mënyrë të përmblodhur.

a. Respektimi i të drejtave të personave të shoqëruar, ndaluar dhe arrestuar në flagrancë në mjediset e Policisë së Rendit

Problemi më i madh i hasur gjatë vitit 2014, në drejtim të respektimit të drejtave të personave të shoqëruar, arrestuar apo ndaluar, nga Policia e Shtetit, lidhet me mbipopullimin e ambienteve të komisariateve. Ky problem së bashku me kushtet e këqija infrastrukturore, të mjedisëve ku mbahen personat e shoqëruar, ndaluar, arrestuar, shkaktojnë cenim të cëndë të të drejtave të këtyre shtetasve. Shkaqet e mbipopullimit janë të ngjashme me ato të përmendura më lart për situatën në institucionet penitenciare.

Në drejtim të KShH-së kanë mbritur ankesa, gjithashtu, lidhur me shkeljen e procedurës mbi njoftimin e të drejtave, që Policia e Shtetit duhet t'u bëjë personave gjatë arrestimit/ndalimit, apo shoqërimit. Në disa prej raste, ankuesit pretendojnë se nuk u është bërë me dije e drejta për të pasur avokat të caktuar nga shteti dhe për pasojë ata nuk kanë patur mundësi të ushtrojnë të drejtën e mbrojtjes me avokat. Në raste të tilla, kur kemi ardhur në dijeni, shtetasit janë këshilluar nga KShH-ja për të gjitha mundësitë ligjore dhe të drejtat gjatë momentit të arrestimeve/ndalimeve, që u rezervon ligji.

Shqetësues vazhdon të mbetet bashkëpunimi ndër-institucional, midis Policisë së Shtetit dhe DPB, për të kryer transferimin e personave me masë sigurie "Arrest me burg" nga policia në institucionet e paraburgimit. Bazuar në legjislacionin në fuqi dhe funksionet e Policisë së Shtetit, mjediset që ata kanë në dispozicion, nuk kanë kushtet e duhura për mbajtjen e shtetasve për periudha të gjata. Për këtë arsye transferimi i personave të arrestuar, sepse kanë qenë në kërkim për të vuajtur dënimin me burg, ose personave me masë sigurie "arrest me burg" drejt

³⁶ Gazeta Shqip/ dt.02.10.2014/Fq.15

³⁷ Gazeta Shqip/ dt 12.09.2014/ Fq.14

³⁸ Gazeta Panorama/10.11.2014/ fq 8; Gazeta Panorama, 22.10.2014/fq 9



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

institucioneve penitenciare është e lidhur drejtpërsëdrejti me mundësimin e respektimit të të drejtave të tyre.

Në disa raste është konstatuar dhe mungesa e mjediseve të veçanta, pranë policisë, për të miturit dhe gratë që trajtohen nga këto organe; mungesë tualetesh në qeli, mungesë krevatesh dhe materialesh të tjera të domosdoshme, duke krijuar kushte që mund të çojnë në trajtim çnjerëzor dhe degradues të shtetasve që vendosen në ato mjedise. Kjo gjë shkel rëndë të drejtat e këtyre personave (konstatuar në Komisariatin nr.1 të Tiranës, Komisariatin e Beratit, Komisariatin Lushnje, etj).

Lidhur me këto probleme të rënda KShH ka bërë reagime tek institucionet përkatëse, ose nëpërmjet deklaratave për shtyp. Për trajtimin e problemit është mundësuar dhe një tryezë pune me titullarët e institucioneve të lartpërmendura. Takime të tilla duhet të jenë më të shpeshta, sepse pavarësisht ndarjeve dikasteriale, të gjitha strukturat e shtetit duhet të veprojnë bashkarisht në drejtim të respektimit të lirive dhe të drejtave të njeriut. Për shtetasit ka një shtet, ai është i pandarë dhe si i tillë duhet të veprojë.

Gjatë kësaj periudhe KShH ka marrë ankesa dhe pretendime për keqtrajtim, nga punonjës të policisë, prej qytetarëve të ndaluar/arrestuar. Fatkeqësisht, nga verifikimet e kryera kemi konstatuar raste të ushtrimit të dhunës nga punonjës të policisë së Lezhës, në Komisariatin e Policisë Elbasan si dhe kemi marrë ankesa të shumta për veprime të tilla nga punonjës së Komisarariatit të Beratit, ku, në kundërshtim me ligjin dhe marrëveshjen e nënëshkruar me DPP nuk u lejuam të takoheshim me të arrestuarin. Ministria e Brendshme dhe Shërbimi i Kontrollit të Brendshëm, pranë këtij dikasteri, pas njoftimit tonë na ka njoftuar për nisjen e hetimeve dhe kalimin e akteve hetimore organit të prokurorisë përkatëse. Jemi në pritje të reagimit edhe për rastin Komisarariatit të Policisë Berat.

Në këtë drejtim ka vend të punohet më shumë për të çrrënjësuar mendësinë e punonjësve të policisë për të marrë deponime kundrejt dhunimit të personit të dyshuar, ose për të ushtuar dhunë edhe kur nuk është e nevojshme. Organet e kontrollit të brendshëm të Ministrisë së Brendshme duhet të reagojnë në vazhdimësi dhe më fort në këtë drejtim, siç kanë vepruar në disa raste.

Probleme vërehen edhe në drejtim të garantimit të shërbimit shëndetësor dhe ushqimit të rregullt për personat e shoqëruar/ndaluar/arrestuar. Përgjithësisht është konstatuar se mungesën e personelit shëndetësor organet e policisë e kanë mbuluar nëpërmjet bashkëpunimit të mirë me institucionet e shëndetit publik, megjithatë kjo çështje e rëndësishme nuk mund t'i lihet spontanitetit dhe vullnetit të mirë të disa punonjësve, por duhet të gjejë zgjidhje me akte normative dhe të shoqërohet me stafin dhe fondet e nevojshme.

b. Respektimi i të drejtave në Pikat e Kalim Kufirit.

KShH ka patur në vëmendje edhe situatën e respektimit të lirive dhe të drejtave të personave që, për arsye të ndryshme, ndalohen e trajtohen nga personeli i Pikave të Kalimit Kufitar. Vërejmë me kënaqësi se investimet e viteve të fundit në këto ambiente kanë krijuar kushte të mira infrastrukturore për këto institucione, ashtu dhe për shtetasit që kalojnë nëpërmjet këtyre pikave, ose ndalohen aty për arsye të ndryshme ligjore. Pranë Pikave të Kalimit Kufitar ka mjedise të veçanta për mbajtjen e shtetasve shqiptarë që kanë problem me dokumentacionin e tyre, për ata që deportohen nga shtetet fqinje, si dhe për shtetasit e huaj që kryejnë kalim të



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

paligjshëm të kufirit. Mjediset janë përgjithësisht me hapësirë, ndriçim e kushte të përshtatshme, por mungon personeli për pastrimin e tyre dhe fondet për përmirësimin e pajisjeve të amortizuara. Problem mbetet përkthimi në gjuhën përkatëse për të huajt që kryejnë kalim të paligjshëm të kufirit. Institucionet e policisë duhet ta zgjidhin këtë problem nëpërmjet rekrutimit të stafëve që njohin gjuhë të huaja, duke ju zhvilluar atyre kurse për këtë qëllim, ose duke punësuar me kohë të pjesëshme persona që i njohin këto gjuhë, sepse dhënia e informacionit, në gjuhën që e kupton, është një e drejtë e rëndësishme njerëzore.

KShH ka monitoruar rastin e shtetasit maqedonas J. G., i cili është ndaluar nga autoritetet kufitare shqiptare. Ai pretendoi se në momentin e arrestimit nuk kishte marrë dijeni rreth garancive procedurale të parashikuara në nenin 31 të Kushtetutës, lidhur me njohjen e akuzës, si dhe mundësinë e ndihmës nga një përkthyes, pasi ai nuk fliste gjuhën shqipe. Ai kishte nënshkruar procesverbalin e kontrollit personal dhe procesverbalin e bllokimit të sendeve personale, të cilat ishin përpiluar vetëm në gjuhën shqipe, pa u njohur me përmbajtjen e tyre. Gjithashtu, ai ka pretenduar se përkthyesi, i siguar më pas nga Prokuroria, gjatë veprimeve hetimore, nuk ishte në gjendje të realizonte përkthim të saktë, për shkak se nuk njihte mirë gjuhën maqedonase.

Për shkak të pozitës gjeografike të vendit tonë këtë vit territori ynë tokësor është përdorur, si rrugë kalimi, për emigrantët e vendeve në konflikte të armatosura si Siria, nga shtetas të vendeve të Lindjes së Mesme, apo të Largët, nga vende të Afrikës, etj. Përgjithësisht këta persona kalojnë nga territori shqiptar, duke pasur si destinacion vendet e BE-së. Si pasojë, në territorin shqiptar janë ndaluar persona të shumtë, të cilët trajtohen nga autoritetet e policisë kufitare dhe të Ministrisë së Brendshme. Këto organe duhet të marrin të gjitha masat për garantimin e respektimit të të drejtave të këtyre personave të huaj.

Nga ana tjetër shtetasit shqiptarë kanë përdorur, në përgjithësi, me korrektësi të drejtën e qarkullimit në zonën e Schengenit e më gjerë, por nuk kanë munguar dhe shkelje të rregullave të lëvizjes së lirë. Kërkesat e shtuara për azil në vendet pritëse, nga ana e shtetasve shqiptarë, nuk janë mirëpritur nga ato vende dhe kanë krijuar shqetësim. Kjo gjë ka rezultuar me kthimin e detyruar në atdhe, të mjaft shtetasve shqiptarë.

Siguria e shtetasve në pikat e kalimit kufitar është, gjithashtu e rëndësishme. Një rast i rëndë keqtrajtimi në kufi, gjatë vitit 2014, ishte ai i dy femrave (nënë e bijë) të dhunuara nga policia e maqedonase. Atyre ju janë sekuestruar dokumentet përkatës dhe janë ndaluar të udhëtojnë për në Shqipëri, për një periudhë afro pesë ditore. Ato janë keqtrajtuar e dhunuar fizikisht nga ajo polici kufitare, gjë e pretenduar prej tyre, por dhe e bërë publike nga mendimet e vendit tonë.³⁹

7. BARAZIA PARA LIGJIT DHE NDALIMI I DISKRIMINIMIT

Mbrojtja nga diskriminimi është tashmë një objektiv i përfshirë në veprimtarinë e organizatave të shoqërisë civile dhe të shumë institucioneve publike, në mënyrë të veçantë kjo e drejtë trajtohet nga KMD, nga Avokati i Popullit, por dhe institucione të tjera. Mbrojtja nga diskriminimi është shndëruar në objektiv dhe temë debati edhe i nismave, që kanë për qëllim të nxitin zhvillimin e shtresave në nevojë. Periudha 5 vjeçare e zbatimit të ligjit "Për mbrojtjen nga diskriminimi", veprimtaria, gjithnjë në rritje e KMD, si dhe veprimtaritë e shoqërisë civile në lidhje me këtë temë, kanë bërë të mundur zgjimin e interesit për këtë të drejtë dhe për

³⁹ Gazeta Shqip, fq 5/ 21.07.2014



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

përdorimin e garancive që ajo ofron. Gjatë vitit 2013 KMD ka marrë 256 ankesa për diskriminim, prej të cilave 17 të paraqitura nga organizata jofitimprurëse me interes legjitim dhe 31 çështje janë marrë në shqyrtim me inisiativë të vet institucionit. Në 27% të rasteve të shqyrtuata është konstatuar diskriminim. Aktivë në këtë drejtim janë treguar organizatat që mbrojnë interesat e komuniteti LGBT, të personave me aftësi të kufizuara, të komuniteti Rom, Egjiptian etj.

Siç dihet Progres-Raporti i BE-së ka sugjeruar, që në kuadër të mbrojtjes së të drejtave të njeriut, komunitetet Roma, LGBT, personat me aftësi të kufizuara, fëmijët dhe gratë të jenë fokus i veçantë për Shqipërinë. Me gjithë punën e kryer, përmirësimet legjislative në favor të këtyre komuniteteve, punësimi, arsimimi dhe strehimi mbeten problemet kryesore të shtresave të varfra të shoqërisë, veçanërisht për komunitetin Roma, si dhe për personat me aftësi të kufizuara.

Manifestim të sjelljeve dhe qëndrimeve diskriminuese ka patur ndaj personave me orientim seksual të ndryshëm. Një rast i rëndë ishte peticioni i firmosur nga disa intelektualë, i bërë publik në ditën e diversitetit. Ky peticion kishte në thelb të tij kërkesën e firmëtarëve, me qëllim që komuniteti LGBT të mos gëzojë të drejtën për jetë familjare. Deklarata e peticionit përmbante në vetvete shprehje fyese, që nuk janë në një linjë me parimet e respektimit të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut.

Strukturat Publike dhe të shoqërisë civile duhet të punojnë më shumë në këtë drejtim, ndërsa komunitetet e personave viktime të diskriminimit duhet të kontribuojnë për informimin e publikut të gjerë rreth veçorive që i karakterizojnë, si dhe të forcojnë kapacitetet dhe bashkëpunimin, në gjirin e shoqërisë civile, për luftimin e sjelljeve diskriminuese dhe integrimin më të mirë të tyre në shoqëri.

a. Diskriminimi i Minoritetit Rom

Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë është angazhuar për hartimin e rekomandimeve mbi përfshirjen e Komunitetit Rom dhe Egjiptian, në punësim dhe në administratën publike, në veçanti, përfshirjen në kurset e formimit profesional, falas, si dhe për krijimin e lehtësive në procedurat e përfitimit të ndihmës ekonomike, etj. Zyra e Avokatit të popullit ka ndërmarrë një sërë nismash dhe ka bërë rekomandime të rëndësishme që tentojnë të përmirësojnë situatën e këtij komuniteti. Megjithatë, faktikisht, nuk është bërë aq sa duhet në këtë drejtim.

KShH, gjatë këtij viti, ka marrë ankesa nga shtetas që u përkasin komunitetit Roma, banorë të Qarkut Lezhë, për diskriminim të fëmijëve të tyre në shkollë, për mungesë aksesit në tregun e punës, për nevojat e shumta për strehim, etj. Në i kemi adresuar këto çështje pranë autoriteteve përkatëse, të cilat janë angazhuar t'i trajtojnë ato me përparësi. Ankesa të ngjashme ka parashtruar edhe komuniteti Roma i qytetit të Korçës, Elbasanit etj.

Nevojat dhe kërkesat e këtij komuniteti janë të njohura, por ende nuk shihen nisma serioze për zgjidhjen e tyre nga ana e autoriteteve publike, veçanërisht në drejtim të strehimit e punësimit të tyre. Kërkohe më tepër vëmendje, investime dhe aksione pozitive për këtë shtresë të marxhinalizuar të shoqërisë.

b. Diskriminimi i Personave me Aftësi të Kufizuara



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

Miratimi i Ligjit nr. 93/2014 "Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara", i cili synon të eliminojë diferencat dhe pabarazitë në trajtimin e personave me aftësi të kufizuara dhe t'u sigurojë atyre respektimin e standartave të Konventës së OKB "Për të drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara", të ratifikuar nga vendi ynë, janë nisma të rëndësishme. Gjithashtu, në muajin Nëntor, KM miratoi vendimin për njohjen e gjuhës së shenjave për njerëzit që nuk flasin dhe nuk dëgjojnë, si një hap përpara drejt respektimit të të drejtave të këtyre shtetasve. Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë është institucioni përgjegjës për hartimin e masave, që do të ndihmojnë në zbatimin e këtij ligji, me anë të të cilave do të përcaktohen detyrimet për institucionet publike që duhet të ofrojnë shërbimin e gjuhës së shenjave. Është ngritur dhe Grupi i Punës Ndërmënyshme për përmirësimin e infrastrukturës në institucionet e administratës publike. Megjithatë nga një monitorim i KShH pranë KMCAP Lezhë, institucion ku personat me aftësi të kufizuara duhet të paraqiten për veprime, u konstatua mungesa e ashensorit apo infrastrukturës së duhur për këtë shtresë shoqërore, duke vështirësuar hyrjen e lirë të tyre në institucion.

Me gjithë përmirësimet, ende ka vonesa për kryerjen e pagesave, që ky komunitet përfiton, veçanërisht në zonat periferike të vendit, ka probleme me arsimimin e këtyre shtetasve, me ofrimin e shërbimeve mjekësore dhe rehabilituese për ta, me punësimin etj. Po punohet me ritme të ulta për zbatimin e standardeve që përcakton Konventa "Për të drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara"

Gjatë vitit 2014 ka pasur ankesa dhe pretendime për diskriminim, për shkak të aftësisë së kufizuar, të cilat i janë drejtuar KMD, nga të cilat, në 6 raste është konstatuar diskriminim.⁴⁰

8. CENIMI I TË DREJTAVE TË SHTETASVE NGA KORRUPSIONI DHE VEPRIMTARIA E KUNDRALIGJSHME E PUNONJËSVE PUBLIKË

Lufta kundër korrupsionit dhe sjelljeve abuzive me detyrën mbetet një nga problematikat e rënda që vendi ynë duhet të zgjidhë dhe njëkohësisht një nga detyrat që na është vendosur nga BE, në kuadër të integritetit evropian. Zyrtarë të BE-së janë shprehur se, veçanërisht, korrupsioni në gjyqësor është problem shumë serioz në Shqipëri.⁴¹

Në vlerësim të situatës në lidhje me këtë fenomen organizata IDRA shprehet se 74% e personave të anketuar janë shprehur se perceptojnë që pandëshkueshmëria për veprimet e kundraligjshme, të kryera, është problem shumë i madh në shoqërinë shqiptare, 85% janë shprehur se korrupsioni është "shumë problem", madje nga 37% e tyre konsiderohet si problemi kryesor në vend.⁴² Në përgjithësi sektorët ku korrupsioni është më evident janë fusha e drejtësisë, sektori i administratës publike, shëndetësia, arsimiti dhe policia.

Një vlerësim mbi korrupsionin në vendin tonë erdhi nga organizata Transparency International, e cila në raportin e saj e renditi Shqipërinë, për vitin 2014, në zonën e kuqe.⁴³ Sipas kësaj renditjeje, vendi ynë u rendit i fundit në rajon, me problematikë kryesore korrupsionin në sektorin publik. Nga një vështrim krahasues me vitin paraardhës, sipas analizës së Transparency International, Shqipëria rezulton 6 vende më lartë se vitin e kaluar, në klasifikimin botëror, duke

⁴⁰ Raporti Vjetor për vitin 2013; "Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi". Fq.29.

⁴¹ Gazeta Shqip dt 21/05/2014

⁴² Slide nr 9

⁴³ Gazeta shqip.com/ Dt. 3.12.2014 <http://gazeta-shqip.com/lajme/2014/12/03/ti-shqiperia-dhe-kosova-ne-zonen-e-kuqe-te-korruptuarat-ne-rajon/>



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

u renditur në vendin e 110, me 33 pikë. Ky tregues shënon një progres të pjesshëm në klasifikimin botëror, por jo në atë rajonal, ku kemi mbetur të fundit. Gjithashtu sipas raportit të Departamentit Amerikan të Shtetit, korrupsioni në Shqipëri është shkelja kryesore e të drejtave të njeriut.⁴⁴

Ky vit shenjon një kthesë të dukshme në drejtim të goditjes së sjelljeve korruptive dhe të atyre në kundërshtim me detyrën, të kryera nga punonjësit publikë, sepse është rritur ndjeshëm denoncimi dhe marrja nën përgjegjësinë penale të këtyre personave, ndërkohë që jemi në pritje të gjyqimit dhe dënimit të tyre, si dhe të ndjekjes në vazhdimësi të këtij problemi.

ILDKP dhe KLSH, dy institucionet e ngarkuara nga ligji si rojtarë të interesave dhe fondeve publike, kanë konstatuar shkelje të shumta gjatë këtij viti. Alarmant ka qenë lajmi i humbjes së dosjeve për hetimin e pasurisë së zyrtarëve të lartë të shtetit, që prej vitit 2003, lajm i cili ngre një pikëpyetje të madhe në lidhje me mirëfunksionimin e këtij institucioni në të kaluarën.⁴⁵ Megjithatë, ILDKP ka kallëzuar në prokurori një numër të konsiderueshëm zyrtarësh, duke përfshirë këtu kryetarë komunash, inspektorë të administratës tatimore si dhe të asaj të shëndetit publik, prokurorë e gjyqtarë⁴⁶ të cilë janë denoncuar për mos plotësimin e detyrimeve për deklarimin e pasurive të tyre, sipas ligjit.

Në këtë drejtim është shqetësues dhe informacioni që vjen nga mediet, lidhur me rritjen me 2.64 herë më shumë i veprimeve të dyshuara për pastrim të parave, veprim që mund të ketë lidhje me korrupsionin ose veprimtari të tjera kriminale. Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parasë⁴⁷, pas verifikimeve të bëra, ka marrë 13 masa administrative bazuar në shkeljet e konstatuara prej saj.

Përgjatë këtij viti, dy kanë qenë skandalet më të mëdha mediatike të lidhura me aferat korruptive dhe të shpërdorimit të detyrës. Përmendim skandalin në kompaninë Albpetrol sh.a. si dhe atë të Bankës së Shqipërisë. Në lidhje me abuzimet në kompaninë Albpetrol sh.a.⁴⁸, KLSH ka kallëzuar penalisht disa persona me pretendimin se kishin krijuar një grup të organizuar kriminal, i cili operonte në mënyrë abuzive me fondet, duke i shkaktuar një dëm kolosal kompanisë, dëm që përlllogaritet në disa miliona euro. Vëmendje të gjerë ka patur për skandalin e vjedhjes në Bankën e Shqipërisë, ku ish- punonjës të kësaj Banke janë akuzuar për vjedhjen e një shume rreth 7 milionë dollarë. Gjatë hetimeve të zhvilluara janë zbuluar shkelje me proceset e tenderimit, abuzime me pagesat dhe dietat e punonjësve, si dhe parregullsi që lidhen me procesin e auditimit të brendshëm të Bankës.⁴⁹

Në fushën e drejtësisë vlen për t'u theksuar se janë vënë nën hetim disa gjyqtarë të niveleve të ndryshme, të cilët janë dyshuar për konsumimin e veprave penale të korrupsionit, shpërdorimit të detyrës si dhe pastrim parash. Këto kallëzime penale janë iniciuar nga ILDKP, i cili ka konstatuar parregullsi me deklaratimet e pasurisë nga gjyqtarët në fjalë. Në të njëjtën kohë, organi i akuzës ka nisur hetimin edhe për disa prokurorë të kallëzuar nga ky institucion.

⁴⁴ Gazeta Integrimi / dt 28.02.2014 /Fq. 6

⁴⁵ Gazeta Panorama / dt.11.03.2014 / Fq.8

⁴⁶ Gazeta Shqip/ dt 25.06.2014 /Fq. 10; Gazeta Shqiptarja, com/ dt 01.04.2014/ Fq. 5; Gazeta Shqip/ dt.04.07.2014/ Fq.14; Gazeta Shqip/ dt.04.07.2014/ Fq.14

⁴⁷ Gazeta Shqiptarja/ dt 28.08.2014/ Fq 16

⁴⁸ Gazeta Panorama/ dt.10.10.2014/ Fq.10

⁴⁹ Gazeta Shqiptarja.com, 23.10.2014/ fq 2; Gazeta Shqip/ dt 17.09.2014/ fq 3; Gazeta Shqip / dt 11.09.2014/ Fq.2; Gazeta Shqip / dt. 12.09.2014/ Fq.3



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

Dyshime për korrupsion ka patur dhe në sistemin shëndetësor, ku janë vënë re abuzime me procedurat e tenderimit të barnave dhe paisjet e spitaleve, për të cilat ka pasur kallëzime penale edhe nga KLSH për disa ish-drejtorë të QSUT⁵⁰. Sjellje të tilla të dënueshme janë rryshfetet e kërkuara nga mjekët dhe personeli ndihmës shëndetësor, prej shtetasve të sëmurë, në këmbim të aksesit për shërbimet shëndetësore.⁵¹

Në sektorin e arsimit, gjithashtu, ka patur denoncime e denoncime në këtë drejtim. Në këtë sektor janë konstatuar dhënia e rryshfeteve në këmbim të marrjes së diplomave, rezultateve të larta në provime⁵², apo nxjerrja e dokumentave false nga ana e zyrtarëve të drejtorive arsimore, apo shkollave të vendit. Për këto akuza janë arrestuar zyrtarë të drejtorive arsimore si dhe inspektorë të Ministrisë së Arsimit.⁵³

Goditje ndaj qëndrimeve korruptive të punonjësve të administratës publike të sektorëve të tatim taksave, raste të korrupsionit të punonjësve të ALUIZNI-t, ku zyrtarë të saj janë arrestuar për shpërdorime me detyrën dhe korrupsion.⁵⁴, për abuzime me tenderat, me lejet e ndërtimit, me pronat e bashkive e komunave të vendit, janë shoqëruar me arrestimin dhe vënien e tyre në ndjekjen penale, në disa qarqe, bashki dhe komuna, si në Tiranë, Vlorë, Shkodër, Librazhd, Bërzhitë⁵⁵, Gruemirë, etj.

E gjithë kjo panoramë flet për shtrirjen e këtij fenomeni dhe për ta luftuar atë, krahas goditjes së autorëve, duhet punuar më shumë dhe për krijimin e një fryme refuzuese ndaj fenomenit nga opinioni shoqëror dhe sektori i veprimtarisë private. Nga ana tjetër ka vend për të vlerësuar më mirë integritetin e personave që u besohen funksione të rëndësishme publike dhe për mbikëqyrjen e tyre në vazhdimësi në këtë drejtim.

9. MBROJTJA E MJEDISIT

Mbrojtja e mjedisit ka qenë dhe vazhdon të jetë shqetësim kryesor për vendin. Mjedisi është nja faktor që lidhet drejtpërsëdrejti me jetën, shëndetin, pronën dhe ekonominë dhe të drejta të tjera të shtetasve. Ai është një faktor që ndikon në të tashmen dhe të ardhmen e jetës së shtetasve.

Gjatë vitit 2014, falë rritjes së sensibilizimit qytetar dhe aksioneve të tyre në këtë drejtim, është vënë re rritje e kujdesit për mbrojtjen e mjedisit, të paktën në zonat e mëdha urbane, si nga pushteti qendror dhe ai lokal. Zëri i shtetasve, të organizuar në protesta, që kundërshtuan importin e mbetjeve toksike luftarake nga Siria, u morr në konsideratë nga qeveria. Përpara sezonit veror u ndërmorr një fushatë pastimi i vendeve turistike dhe i rrugëve nacionale. Ka vazhduar investimi për ndërtimin dhe rikonstruksionin e disa rrugëve nacionale dhe lokale, është rritur vëmendja për të mos lejuar prerjen e paligjshme të pyjeve. Nga Inspektoriati Shtetëror i Mjedisit, gjatë këtij viti, u ndërmor një aksion me fokus verifikimin e lejeve përkatëse si dhe ndotjen akustike që shkaktonin aktivitetet tregtare për komunitetin. Gjjobat e vëna arrijnë shumën 85 milionë e 560 mijë lekë, por problemet me këtë lloj ndotjeje vazhdojnë ende, sepse nuk ka ndjekje të vazhdueshme të problemit.

⁵⁰ Gazeta Shqiptarja.com/ dt.02.10.2014/ Fq. 14

⁵¹ Gazeta Panorama/ dt 09.06.2014

⁵² Gazeta Panorama/ dt08.07.2014/ Fq. 13

⁵³ Gazeta Panorama, dt.14.05.2014; Gazeta Shqiptarja/ dt 21.02.2014

⁵⁴ Gazeta Shqip/ dt.04.07.2014/ Fq.14

⁵⁵ Gazeta Panorama/ dt 04.09.2014



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT

ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

Referuar medieeve, në një raport të Agjencisë Europiane të Mjedisit, Shqipëria ka ngjitur 13 vende, në listimin e vendeve, lidhur me ruajtjen e mjedisit, krahasuar me një vit më parë, duke u renditur në vendin e 26-të. Në këtë sektor rezulton se shteti ka marrë disa masa për përmirësimin e situatës, por problemet janë ende të mëdha dhe në këtë drejtim ka dëmtime të shumta. Ndotja e ajrit mbetet në parametra të lartë; për grumbullimin dhe përpunimin e plehrave urbane dhe industriale ende nuk po ndermerren nisma që do të japin zgjidhje bashkëkohore dhe afatgjatë për këtë çështje; shtimi i gjelbërimit dhe pyllësimit po ecën me ritme të ulta dhe është ende larg parametrave të nevojshëm.

KShH ka ndjekur disa raste të ndotjes së mjedisit, me pasojat rënda për shëndetin e banorëve të zonave përreth, që shkaktohet nga veprimtaria prodhuese private. Rast i tillë është ai i fshatit Plug, Komuna Golem, në Lushnjë, ku banorët janë ankuar për ndotjen e ajrit nga impianti i një rafinerie private. Për këtë shqetësim është vënë në dijeni Ministria e Mjedisit dhe Agjencia Kombëtare e Mjedisit, të cilat na kanë vënë në dijeni se kjo veprimtari prodhuese private do të detyrohet të sigurojë mbrojtjen e përbërësve dhe cilësisë së ajrit për të shmangur efektet e dëmshme mbi shëndetin e njeriut, jetën e tyre familjare, cilësinë e jetës dhe mjedisin në tërësi.

Një monitorim tjetër në fushën e mjedisit është ai i kryer në fshatrat e Komunës Zharrës, të Marinëzës, e Vërrisë, në Qarkun Fier, ku u konstatua ajër i rëndë e mbytës, për shkak të pranisë së lartë të gazit të çliruar nga nafta që nxirrej prej puseve aty pranë, nga 2 kompanive private. Sipas banorëve, prania e lartë e gazit në ajër dhe ndotja e ajrit kishte shkaktuar sëmundje në rrugët e frymëmarrjes, si dhe sëmundje të tjera të rënda tek banorët, fakte këto të pranuar verbalisht edhe nga punonjës të Qendrës së Shëndetit Publik Fier. Të njëjtin shqetësim kanë parashtruar dhe banorët e fshatit Kozarë, në Berat, lidhur me shfrytëzimin e puseve të naftës nga kompania që vepron në atë zonë.

Për këto problem i jemi drejtuar Ministrit të Energjisë dhe Industrisë, Ministrit të Mjedisit, Ministrit të Shëndetësisë si dhe disa komisioneve parlamentare. Përveç verifikimit të gjëndjes nga specialistë të Institutit të Shëndetit Publik, të cilët na informuan se nuk disponojnë gjithë mjetet e nevojshme për të analizuar situatën, institucionet e tjera shtetërore nuk na kanë kryer përgjigje.

Mediet kanë trajtuar shpesh prerjen e paligjshme të pyjeve, si dhe marrjen e disa masave administrative, ose bërjen e 200 kallëzime penale nga Ministria e Mjedisit, gjë që tregon se kjo veprimtari ka shtrirje të gjerë.⁵⁶ Mediet kanë trajtuar, gjithashtu, ndotjen e mjedisit nga mbetjet spitalore, të cilat hidhen nëpër lumenj, ose në afërsi të zonave urbane. Disa nga subjektet e licensuara për përpunimin e këtyre mbetjeve nuk zbatonin kriteret përkatëse të veprimtarisë, prandaj u gjobitën, ndërsa disa të tjerave ju hoq licenca për zhvillimin e aktivitetit.

Probleme të ndotjes së mjedisit janë konstatuar dhe në zonën turistike bregdetare. Të tilla përmendim rastin e Golemit, në Durrës, ku uji i pijshëm është përzier me ujërat e ndotura, ose ndotjen e mjedisit nga mbetje pesticidesh, mjaft të rrezikshme, në zonën e Lukovës në Sarandë⁵⁷.

⁵⁶ Gazeta Shqiptarja.com; Datë 05.11.2014, Fq.14.

⁵⁷ Gazeta Panorama; Datë 17.07.2014, Fq.13.



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

Që në fillim të vitit 2014, pati përmytje si pasojë e rreshjeve të dëndura, ku ndër zonat më të prekura rezultoi Shkodra dhe Lezha. Rreth 5000 hektarë tokë u përmytën, dhe disa lumenj dolën nga shtrati.⁵⁸ Për më tepër në kohën kur intesiteti i rreshjeve ka qënë i lartë banorët nuk janë furnizuar me energji. Zonat janë inspektuar nga ministritë përkatëse, si dhe u krijuan shtabet e emergjencës. Sipas raportimeve në media, rezulton se nga Ministria e Bujqësisë, janë ndërmarrë masa për funksionimin e hidrovorëve dhe në funksion të largimit të ujit, ose për t'i paraprirë situatës si, rehabilitimi i hidrovorit të Velipojës, vendosja e pompave në hidrovorin e Çasit në Shkodër dhe të Tales në Lezhë, pastrimi i kanalit me gjatësi 2000 metra, nga Ura e Dajlanit e deri në Shkozë të Durrësit, si dhe përfundoi argjinatura mbrojtëse nga lumi Seman në Fier⁵⁹.

Në muajin Nëntor pati sërish reshje të shiu, si pasojë e të cilave humbën jetën dy qytetarë⁶⁰. Në qarkun e Lezhës, si një zonë me problematikë, u mobizilua edhe ushtia. Megjithatë në Lezhë uji arriti deri në 1 metër lartësi, ndërsa në Tiranë deri në 50 cm., ku mjaft shtëpi dhe biznese u përmytën nga niveli i lartë i ujit. Gjatë muajit Nëntor, reshjet e dëndura të shiut izoluan fshatra e u përmytën shtëpi, u shëmbën ura dhe u izoluan fshatra në Mat dhe Kukës, ku humbi jetën edhe një 23 vjeçar⁶¹. Kjo tregon se efënca e investimeve dhe ndërhyrjeve të kryera le për të dëshiruar dhe se jeta, shëndeti dhe pasuria e shtetasve mbeten në rrezik.

10. INFORMIMI PËRFSHIRJA DHE PJESMARRJA E PUBLIKUT NË ÇËSHTJET PUBLIKE

Miratimi i Ligjit të ri, nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit"⁶², solli ndryshime pozitive në drejtim të mundësisimit dhe zbatimit të të drejtës së shtetasve për informim. Gjithashtu Ligji nr. 146/2014 "Për njoftimin dhe konsultimin publik" sjell hapjen e institucioneve publike për bashkëpunim me grupet e interesit dhe organizatat e shtetasve në kuadër të hartimit të politikave, strategjive dhe legjislacionit të ri. Parlamenti miratoi, gjithashtu, Ligjin nr. 93/2014 "Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara", Rezolutën "Për njohjen dhe forcimin e rolit të shoqërisë civile në procesin e zhvillimeve demokratike të vendit", ndërsa në muajin Nëntor 2014, KM miratoi vendimin për njohjen e gjuhës së shenjave, si mjet informimi për njerëzit që nuk flasin dhe nuk dëgjojnë. Të gjitha këto akte, hartimi i të cilave është bërë edhe me kontributin e shoqërisë civile, do të kontribuojnë për informimin dhe përfshirjen më të mirë të shtetasve në çështjet publike. Në këtë drejtim duhet të shmanget formalizmi dhe përzgjedhja me preferencë e oj-ve që konsultohen, ose përfshihen.

KShH dhe shumë organizata të shoqërisë civile kanë kontribuar, me vërejtjet e sugjerimet e tyre, në lidhje me ndryshimet në ligjin nr. 8328, dt. 16.04.1998 "Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve dhe të paraburgosurve", i ndryshuar; për ligjin nr. 10 039, dt. 22.12.2008, "Mbi ndihmën juridike", i ndryshuar; ligjin nr. 108/2014, "Për Policinë e Shtetit"; për ndryshimet në ligjin nr. 8454, dt. 04.02.1999, "Për Avokatin e Popullit", i ndryshuar; për ndryshimet në ligjin nr. 7895, dt. 27.01.1995, "Kodi i Penal i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar; për ndryshimet në ligjin nr. 8811, dt. 17.05.2011, "Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë"; për ndryshimet në ligjin nr. 10032, dt. 11.12.2008 "Mbi Policinë e Burgjeve", i

⁵⁸ Gazeta Standard; Datë 23.01.2014, Fq.10

⁵⁹ Gazeta Zëri I Popullit; Datë 23.01.2014, Fq.6.

⁶⁰ Gazeta Shqip; Datë 19.11.2014, Fq.11.

⁶¹ Gazeta Shqiptarja.com; Datë 21.11.2014, Fq.9.

⁶² Gazeta Panorama; Datë 04.09.2014, Fq.4 dhe referuar faqes zyrtare të parlamentit:

http://ëëë.parlament.al/ëëb/pub/ligj_nr_119_dt_18_9_2014_19327_1.pdf



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

ndryshuar; për ligjin nr. 119/2014, "Për të drejtën e informimit", për ligjin "Për Shërbimin e Kontrollit të Brendshëm në Ministrinë e Drejtësisë"; ligjin nr. 147/2014, "Mbi urgjencën mjekësore", etj.

Gjithashtu, janë dhënë sugjerime lidhur me disa projektligje, në proces hartimi si, projekti për përmirësimin e ligjit nr. 10 221, dt. 04.02.2014, "Për mbrojtjen nga diskriminimi", projekti për ligjin "Për bilbilfryrësit" dhe për projektvendimin e KM "Mbi nxitjen dhe shpërblimin e punës së të dënuarve dhe të paraburgosurve", etj.

Megjithatë, rezulton të jenë miratuar, pa u konsultuar me shoqërinë civile dhe grupet e interesit, disa ligje apo akte nënligjore. Jemi të shqetësuar, veçanërisht, për punën e mbyllur dhe jo transparente të kryer në lidhje me ndryshimet në Kodin Zgjedhor. Procesi zgjedhor ka në qendër të vëmendjes zgjedhësin dhe zgjedhjet janë një nga momentet e rëndësishme të ushtrimit të sovranitetit të popullit, në mënyrë të drejtëpërdrejtë. Nga kjo pikëpamje, ligji zgjedhor dhe monitorimi i zgjedhjeve janë me shumë interes për shoqërinë civile dhe shtetasit në përgjithësi. Klasa politike e vendit nuk duhet të pengojë kontributin e organizatave të shoqërisë civile në këtë fushë.

Urdhëri i Ministrit të Financave nr. 87, datë 04.11.2014 "Mbi disiplinimin e kryerjes së pagesave të energjisë elektrike nga punonjësit e Ministrisë së Financave dhe institucionet e varësisë" ka ngjallur debat në opinionin publik. Sipas këtij urdhëri, të gjithë degët e financave të institucioneve janë urdhëruar të mbajnë paratë nga rroga për ata punonjës që nuk kanë paguar detyrimet për energjinë elektrike. Punonjësit, të cilët nuk paguajnë detyrimet përkatëse, do të marrin vërejtje në Librezën e Punës ose masa të tjera disiplinore. Kundër këtij Urdhëri ka reaguar Avokati i Popullit, i cili ka kërkuar rishikimin e tij. Sipas këtij institucioni, ky urdhër bie ndesh me parimet bazë në të cilën mbështetet puna e nëpunësve të administratës. Urdhëri është ende në fuqi. Veprime të tilla janë kryer edhe nga institucione të tjera publike. Duke vlerësuar aksionin e qeverisë për të nxitur shlyerjen e detyrimeve, që subjekte të ndryshme i kanë kompanive që shpërndajnë energjinë elektrike, ujin etj., shohim me shqetësim konfuzionin e krijuar midis marrëdhënies së punësimit dhe detyrimeve kontraktuale që shtetasit kanë, jashtë kësaj marrëdhënie.

Është e nevojshme që për të forcuar punën në drejtim të respektimit të lirive dhe të drejtave të njeriut, institucioneve publike, të krijuara për këtë qëllim, si Avokati i Popullit, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi etj, t'u forcohet më tepër pavarësia institucionale dhe financiare dhe raportet e rekomandimet e tyre të merren në shqyrtim, sa më parë, nga organet ku janë adresuar, si dhe të rritet bashkëpunimi i tyre me organizatat e shoqërisë civile.